



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 04 shkurt 2015, në mbledhjen e XIII-të (trembëdhjetë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10:05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm, drejtorët e Drejtorive komunale, z. Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen dhe shtoi, konsideroj se rendin e ditës dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë, andaj mund të vazhdojmë me punë.

z. Haki Rudari, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur dy ditë më parë unë kam propozuar një pikë të veçantë për përfshirje në rend të ditës për këtë mbledhje, përkatësisht një informatë nga Drejtoria e Arsimit, për gjendjen në arsimin e Komunës së Podujevës, konkretisht rreth migrimit apo braktisjes së nxënësve nga shkollat, çështje për të cilën mendojmë se do të ishte shumë më e rëndësishme të debatojmë sot për këtë se sa vetëm ajo informatë që na është dërguar në formë të shkruar. Gjithashtu propozoj që në mbledhjen e radhës të kemi një raport nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, konkretisht rreth "hotel Llapit", për arsye se ne si këshilltarë është mirë që të kemi një raport në mënyrë të detajuar se si ka ardhur deri te privatizimi i atyre ndërmarrjeve komunale.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, sqarim, me përjashtim të një anëtari, rekomandim i KPF-së është që të jetë vetëm një informatë rreth arsimit, ndërsa për të debatuar për këtë temë ne mundemi në një mbledhje të ardhshme, andaj gjithë ne kemi materialin rreth gjendjes së arsimit në Komunën e Podujevës ku paraqiten në formë të shkruar të gjitha të dhënat dhe statistikat tjera në mënyrë të detajuar nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, mirëpo sido që të jetë e hedh në votim propozimin e parafolësit për përfshirje në rend dite pikën e veçantë, debat rreth migrimit apo braktisjes së nxënësve nga shkollat.

Pas votimit u konstatua se me 3 vota për dhe 30 vota kundër, nuk u miratua ky propozim.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

Pas votimit u konstatua se me 31 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur miratohet rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 30 dhjetor 2014

z. Haki Rudari, lidhur me procesverbalin, theksoi, ne si Grup kemi dhënë vërejtje në mbledhjen e njëmbëdhjetë, dhe këtu në procesverbal figuron një sqarim ku mes tjerash thuhet, po e citoj, *andaj pas ridëgjimit të regjistrimit audio të mbledhjes përkatëse është verifikuar se në pikën e rendit të ditës të ndryshme nuk ka pasur diskutime*, kurse vërejtja e Grupit ka qenë që nuk është lejuar të ketë diskutime dhe ajo pikë e rendit të ditës është përfunduar pa pasur diskutime, kështu që është dashur të formulohet më mirë edhe kërkoj të bëhet ky ndryshim i procesverbalit.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, diskutimet nxjerrën në bazë të incizimit të mbledhjes, andaj për atë mbledhje për të cilën ju keni bërë vërejtje se nuk iu është dhënë fjala në pikën të ndryshme, nuk ka të bëjë me vërejtje në procesverbal ngase ajo mbledhje është konstatuar e mbyllur, pra sqarimi kishte këtë qëllim, mirëpo nëse mundet Zyra ligjore të konstatojë atë vërejtje që ju thoni, do të ishte në rregull.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 30 dhjetor 2014.

3. Propozimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës

➤ Raporti nga debati publik lidhur me propozimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në fjalën hyrëse ndër të tjera shtoi, ne konform vendimit të Kuvendit kemi mbajtur debat publik rreth kësaj propozim rregulloreje dhe ne bazë të vërejtjeve dhe sugjerimeve të marra nga qytetarët kemi arritur t'i bëjmë disa përmirësime, plotësime dhe ndryshime të cilat i kemi konsideruar si të arsyeshme e të cilat janë të evidentuara në raportin përkatës. I falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë duke përfshirë edhe anëtarët e KPF-së të cilët i kanë dhënë mbështetje këtij propozimi, mirëpo unë jam i gatshëm që në një mbledhje të ardhshme të debatojmë për gjendjen e Kompanisë, mënyrën e menaxhimit të mbeturinave, zgjerimin e kompetencave të Kompanisë apo zgjerimin e rrjetit të menaxhimit të mbeturinave edhe në fshatra e të tjera. Pra kërkoj nga ju që të miratoni këtë propozim Rregullore, por njëkohësisht nëse keni propozime, vërejtje apo sugjerime mund t'i jepni me qëllim që menaxhimi i mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës të bëhet në mënyrë sa më të mirë.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, konsideroj se sqarimet dhe detajet lidhur me propozim Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës përkatësisht raportin nga debati publik i dha drejtori parafolës, kështu që ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim këtë propozim Rregullorë me plotësim ndryshimet e bëra.

z. Kadri Avdiu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve PDK-së e përkrahim këtë propozim rregullorë, konsiderojmë se në mbledhjen e KPF-së i kemi dhënë vërejtjet, sugjerimet dhe plotësimet tona të cilat kryesisht kanë të bëjnë me zgjerimin e rrjetit të menaxhimit të mbeturinave edhe në fshatrat e Komunës së Podujevës, çështje për të cilën besoj se janë marrë parasysh nga Drejtoria përkatëse dhe në të ardhmen do të aplikohet edhe ajo.

z. Bahri Selimi, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje në parim e mbështetë këtë propozim Rregullorë, me disa vërejtje të cilat janë dhënë në mbledhjen e KPF-së. Lidhur me debatet me qytetarë kohë e cila ka qenë afërsisht një muaj dhe është mbajtur vetëm një debat, kemi vërejtje sepse ka pasur mundësi të mbahen më shumë debate gjë e cila me siguri se do të kishte më shumë efekt.

Ne mendojmë se dy kontejner për biznese të mëdha janë pak, por duke pasur parasysh riciklimin e mbeturinave do të duhej të jenë 3 kontejner, të ndarë dhe me mbishkrime për mbeturinat e qelqit, plastikës dhe të letrës, kjo do të lehtësonte riciklimin e mbeturinave.

Çështje tjetër që dua ta ngris ka të bëjë me shumë deponi të mbeturinave të krijuara në rrugë dhe fshatra të Komunës së Podujevës, andaj e shtroj si pyetje, a është paraparë dhe a do të ishte mirë të përfshihet në këtë Rregullorë edhe menaxhimi i atyre mbeturinave, çështje për të cilën konsideroj se me nënshkrimin e një kontrate me Kompaninë përkatëse do të mund të realizohej kjo, shembull konkret, te vendi quajtur Tabet e Llapashticës afër përmendores së Dëshmorëve vërehen mbeturina të shumta, gjithashtu ka edhe shume vende tjera në periferi të qytetit dhe në fshatra të Podujevës që ekzistojnë deponi të tilla të mbeturinave.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, fillimisht kam vërejtje rreth kësaj mbledhjeje për arsye se në mbledhjen e kaluar është miratuar Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015, kurse tani qysh në seancën e parë nuk respektohet ai plan ngase mbledhja është dashur të mbahet në janar. Sa i përket propozim Rregullores për menaxhimin e mbeturinave konsideroj se është mirë që tani kemi një rregullorë të tillë duke parë gjendjen aktuale të mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës, mirëpo unë do të ndalem shkurtimisht rreth menaxhimit të mbeturinave përreth liqenit të Batllavës si zonë nacionale dhe si vlerë komunale, ku vitin e kaluar nga ky Kuvend është marrë një Vendim, njëanshëm dhe pa procedura të konkurrencës, për një Kompani që të menaxhoj me mbeturinat në atë pjesë, e ngrita këtë ngase unë kam vizituar atë zonë tash së fundmi dhe kam vërejtur se me mbeturina nuk është duke u marr askush, andaj i bëjë thirrje dhe i sugjeroj zyrtarëve përgjegjës komunal që të angazhohen në menaxhimin e mbeturinave rreth liqenit të Batllavës, konkretisht rruga që qon për në fshatin Ballaban pasi që kemi deponi të mbeturinave dhe plehrave të kafshëve, gjithashtu shumica e kanalizimeve të fshatit Orllan rrjedhin në liqenin e Batllavës. Pra paraqitet nevojë urgjente të merren masa për menaxhimin e mbeturinave në zonën e Batllavës dhe Orllanit, dhe unë i bëjë thirrje Ekzekutivit të Komunës dhe Drejtorisë përkatëse të bënë inspektimin e hapësirave përreth liqenit ngase edhe fshatrat Orllan dhe Batllavë janë në territorin e Komunës së Podujevës ose ta obligon kompaninë përkatëse që të merret më shumë me menaxhimin e mbeturinave në ato lokalitete.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me vërejtjet e parafolësit rreth kësaj seance, unë them se kjo mbledhje është shtyrë për 4-5 ditë për shkak të pikave të shumta në këtë rend të ditës dhe përgatitjen e materialeve, mirëpo shpresoj që në të ardhmen Plani i Punës për vitin 2015 do të respektohet sipas planifikimeve, dhe në bashkëpunim me drejtorët e Drejtorive besoj se do ta përmbushim atë Plan.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, do të mundohem t'i jap disa sqarim. Lidhur me vërejtjen e z. Bahri Selimit për numrin e kontejnerëve në hapësirat e bizneseve të mëdha, mendoj se neni 6.4 në një formë e parasheh atë që u tha nga parafolësi ku thuhet se numri i kontejnerëve duhet të përshtatet në objektet e përbashkëta të banimit dhe për llojin e mbeturinave që krijohen, e them këtë ngase nuk kufizohet vetëm në dy kontejnerë, pastaj kompania përkatëse me rastin e përpilimit të kontratave me banorë të objekteve të ndryshme e përshtat atë me nevojën e kërkuar, do të thotë se nuk është kufizuar numri i kontejnerëve, mirëpo si do që të jetë unë e thash edhe më parë se ne mund të bëjmë një debat të veçantë për mënyrën e menaxhimit të mbeturinave duke i ftuar në mbledhje edhe përfaqësuesit e Kompanisë, kurse tani për tani riciklimi i mbeturinave nuk mund të bëhet jo vetëm në nivel lokal por as në nivel të vendit. Sa i përket liqenit të Batllavës, jeni në dijeni se kemi të nënshkruar një kontratë të përgjithshme për menaxhimin e mbeturinave kryesisht në qytet me kompaninë regjionale e cila është e vetmja e licencuar, kontrata të cilat janë unike në tërë Kosovën dhe me tarifa unike, ndërsa për rastin e Batllavës kemi një kontratë të veçantë për shërbime të veçanta dhe kjo nuk ka të bëjë me atë të përgjithshmen por është diçka tjetër, mirëpo unë do të mundohem t'i koordinoj punët edhe me Drejtorinë e Inspeksionit dhe Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit për menaxhimin e mbeturinave në zonën e Batllavës.

Unë nuk vërejtja diçka më shumë që duhet të precizohet në këtë Rregullore, ndërsa të gjitha çështjet tjera që mbesin janë plane operacionale të veprimit të cilat i merr Komuna.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, i falënderoj të gjithë ata të cilët kanë kontribuar në hartimin e kësaj Rregulloreje, mendoj se të gjitha këto vërejtje dhe sugjerime që u dhanë sot duhet të merren parasysh. E hedh në votim propozimin e kësaj rregulloreje me rekomandimin e KPF-së.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës.

4. Propozimi i vendimit për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë jam kryesues i komisionit përkatës të cilin e formuar ky Kuvend nga këshilltarë/e të Kuvendit dhe nga ekspertë të fushave të ndryshme nga shoqëria civile për këtë projekt që është një ndër më të rëndësishmit e këtij Kuvendi, jam i obliguar të jap një fjalë hyrëse.

Komisioni është takuar në përbërje të plotë dhe ka bërë planin e punës për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës, dhe kemi mbajtur rreth 60 takime si komision, gjithashtu me kohë kemi njoftuar me shkrim dhe në mënyrë elektronike përmes faqes zyrtare të Komunës të gjitha fshatrat, lokalitetet dhe bashkësitë lokale, siç janë quajtur përpara, pastaj kemi mbajtur diskutime publike në gjitha meset

dhe fshatrat, takime në të cilat kryesisht kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e komisionit edhe drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit duke iu dhënë qytetarëve sqarime dhe shpjegime të ndryshme me kinoprojektor për secilën rrugë dhe rrugicë. Vlen të ceket se pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë shumë e kënaqshme në ato debate publike ku janë dhënë propozime për emërtime të rrugëve dhe rrugicave nga vetë banorët, propozime të cilat janë evidentuar me procesverbal.

Sigurisht jeni në dijeni se në bazë të Agjensionit Kadastral të Kosovës ekzistojnë rreth 1300 rrugë të evidentuara me kode përkatëse dhe ka pasur raste jo të pakta ku për një rrugë janë propozuar 2 deri në 3 emra të cilat komisioni pastaj ka bërë shqyrtimin e të gjitha propozimeve si dhe ankesave dhe peticioneve të ndryshme të mëvonshme. Pastaj kemi kërkuar edhe një herë nga të gjitha komunitetet e fshatrave dhe gjitha lagjet e qytetit që të bashkëpunojnë mes veti dhe të sjellin propozimet për të cilat janë të pajtimit të gjithë banorët e rrugëve përkatëse, e gjithë kjo është bërë me qëllim që në të ardhmen të mos ketë mospajtime eventuale për ndonjë rrugë. Falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit për bashkëpunim të mirë dhe pa kurrfarë përçarjesh mes veti.

Pas gjitha këtyre ne si komision kemi propozuar këtë draft – listë të emërtimeve të rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës, listë e cila pastaj është shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa ku njëzëri janë bërë disa ndryshim plotësime, duke përfshirë edhe listën me emra rezervë, të cilat i janë rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, rekomandime të cilat janë pjesë përbërëse e propozim listës së emërtimeve të rrugëve dhe rrugicave.

znj. Fatlume Jaha, theksoi, se që nga data 10 prill 2014 kur është formuar dhe ka filluar punën komisioni për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës e deri më sot janë bërë 10 muaj. Natyrisht se nuk ka qenë punë e lehtë aspak dhe këtë e them me përgjegjësi të plotë se ka qenë një punë më e vështirë se sa që është menduar në fillim për shkak se kemi organizuar debate publike që nga data 5 maj 2014 duke filluar me debatin e parë në fshatin Zhiti deri më 21 maj 2014 që është mbajtur në këtë sallë debati i fundit me qytetarë të Podujevës – Podujeva 3, andaj nëse merret parasysh një parim në ekonomi që thotë se burimet janë të kufizuara kurse kërkesat janë të pakufizuara, them se ka qenë shumë punë e vështirë që të plotësohen kërkesat dhe dëshirat e secilit individ. Mirëpo duke marrë parasysh kompaktësinë dhe seriozitetin e punës së këtij komisioni besoj se kemi arritur që sot ta kemi një draft final të pranueshëm të të gjitha rrugëve dhe rrugicave të territorit të Komunës së Podujevës, mbi njëmijë rrugë e rrugica, të cilat ndoshta është pak sa e vështirë vetëm të shfletohen dhe të lexohen, e lëre më të punohet i gjithë ky material. Mirëpo kur kemi parasysh propozimet për secilën rrugë - rrugicë ne na është dashur të merremi veç e veç, për të gjetur emërtimin adekuat, duke mos përjashtuar edhe debate të “nxehta” e që në disa raste është dashur që anëtarët e komisionit të ndërhyjnë edhe në familje të ndryshme me qëllim të gjetjes së një pajtueshmërie mes familjeve ose lagjeve të ndryshme. Gjithë kjo punë është bërë me qëllimin tonë më të mirë si anëtarë të komisionit që të kemi emra të rrugëve dhe rrugicave me të cilët do të krenohemi edhe ne si komision që i kemi vendosur por natyrisht edhe qytetarët të mbeten të kënaqur me emërtimet e rrugëve të lagjeve ku ata jetojnë dhe të të gjitha rrugëve në përgjithësi. Prandaj duke pasur para sysh se asgjë në këtë botë nuk mund të jetë absolute, mund të ketë edhe ndonjë lëshim të vogël në këtë listë, por unë ju siguroj se ky komision është munduar të kryej punën e vet në mënyrën më të mirë të mundshme brenda mundësive dhe kapaciteteve të veta, dhe duke pasur parasysh

rëndësinë jetike që ka ky projekt për Komunën e Podujevës dhe për Kosovën si shtet i ri, i cili pretendon të jetë anëtar i Bashkimit Evropian, me përgjegjësinë më të madhe, ju ftoj ta përkrahni këtë sepse konsideroj se do të jetë në të mirë të të gjithë qytetarëve Llapjan.

z. Kadri Avdiu, theksoi, fillimisht e them se plotësisht qëndrojnë ato që dy parafolësit i ceken, dhe unë nuk dua t'i përsërisë sepse ashtu edhe është. Është e vërtetë se është bërë një punë bukur e madhe nga ana e komisionit, por unë dua të them vetëm në një gjë me qëllim që të merret e kuptueshme në aspektin që ndokush mund të thotë se disa emra janë vënë me kuptim jo të duhur, pra ata emra mund të jenë emra të baballarëve, gjyshërve të tyre, ose të ngjashme të cilët familjet kanë qenë këmbëngulëse se duhet të jenë në rrugë të caktuara e që ne si komision nuk kemi pasur mundësi t'i ndryshojmë me ndonjë toponim ose me ndonjë emër më meritorë të mundshëm, andaj krejt ajo që mund të përfillet rreth emërtimeve të rrugëve mund të jetë në këto raste të cilat janë kryesisht për rrugë apo rrugica të fshatrave por edhe në disa raste në periferi të qytetit, kurse pjesa tjetër është punuar me konsensus të plotë mes anëtarëve të komisionit me qëllim të tejkalimit të ndonjë ngatërresa të mundshme mes familjeve. Prandaj duke u bazuar në punën tonë si komision, ne e mbështesim këtë propozim listë duke përfshirë edhe plotësim ndryshimet e rekomanduara nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

z. Bahri Selimi, theksoi, sa i përket këtij propozimi jam plotësisht në dakord me fjalët e tre parafolësve. Është e vërtetë që puna e komisionit ka qenë e madhe, me angazhime e sakrifica të mëdha dhe me përkushtim të madh duke u munduar që të përmbillet sa më mirë, por duke mos përjashtuar se mund të ketë vend edhe për vërejtje, mirëpo qëllimi jonë ka qenë që t'i ofrohet Kuvendit propozimi më i mirë i mundshëm.

Unë në cilësinë e anëtarit të komisionit përkatës kam disa vërejtje të cilat i kam nxjerr gjatë kohës së punëve në komision si dhe disa vërejtje tash së fundmi, dhe atë, përveç asaj që është bërë një punë e mirë konsideroj se ajo është stërzgatur gjë për të cilën mendoj se ne anëtarët e komisionit duhet të kërkojmë një lloj faljeje para këshilltarëve të Kuvendit, e them këtë ngase këshilltarët kanë pritur aq gjatë derisa ne kemi përgatitur një propozim listë sepse kjo ka filluar në muajin prill dhe ka qenë e paraparë të përfundoj në muajin gusht 2014, e që nuk ka arritur të bëhet një gjë e tillë, dhe tani në shkurt 2015 kemi një propozim listë të emrave për rrugë dhe rrugicave, vërejtja tjetër që unë dua ta bëjë është se në mbledhjen e fundit të Komitetit për Politikë dhe Financa janë bërë disa ndryshime të cilat i janë rekomanduar Kuvendit, gjë për të cilën unë mendoj se nuk është dashur që ato ndryshime të bëhen pa prezencën e të gjithë anëtarëve të komisionit, sepse komisioni përkatës ka bërë një punë dhjetë mujore kurse KPF pa prezencën e tyre bënë ndryshime e që unë mendoj se për ne anëtarët e komisionit është e papranueshme që në momentin final të mos jemi pjesë e këtyre ndryshimeve të rekomanduara për Kuvendin e Komunës, ndryshime të cilat tani me siguri se do të votohen pa qenë në dijeni anëtarët e komisionit të cilët nuk janë këshilltarë të Kuvendit të Komunës. Çështje tjetër që unë kam për të thënë është një vërejtje të cilën unë e kam bërë edhe në disa komunikata të më hershme e që ka të bëjë me intervenime për emra të rrugëve nga persona që nuk ishin pjesë e komisionit gjë e cila nuk më ka bërë përshtypje të mirë, mirëpo me një bashkëpunim dhe angazhim të anëtarëve të komisionit edhe përkundër atyre intervenimeve kemi arritur të marrim vendim final i cili është për tu lavdëruar.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, nuk dua të lëshohem në detaje rreth shqetësimeve për ndërhyrje politike ose të qeverisjes lokale në emërtime të rrugëve sepse kanë qenë shqetësime edhe në media, por as në shqetësimet e komiteteve të fshatrave dhe

vendbanimeve të ndryshme apo të individëve sepse kjo ka qenë punë e komisionit i cili është përgjegjës. Unë si anëtarë i KPF-së e ndiej për obligim të cekë për shkak se drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit në mbledhjen e KPF-së ka sjellë rreth 16 emra - kode të rrugëve të cilat nuk janë pranuar nga Agjensioni Kadastral si, një rrugë në fshatin Revuç, masakra e shtatorit e të tjerë, mirëpo unë mendoj se Zyra ligjore është dashur që të gjitha propozim ndryshimet që janë bërë në mbledhjen e KPF-së është t’jua dërgojnë anëtarëve të komisionit të cilët nuk janë këshilltarë të këtij Kuvendi, kështu që konsideroj se z. Bahri Selimi ka plotësisht të drejtë kur thotë se është dashur që për ndryshim plotësimet të njoftohen edhe anëtarët tjerë të komisionit. Sa i përket listës me emra rezervë unë nuk vërejta ndonjë ndryshim të madh që është bërë nga ajo që na është paraqitur në KPF dhe për këtë unë jam i mendimit se shumë më mirë do të ishte të mos votohet sot fare lista me emra rezervë por me vendim të jepet një afat kohor që kësaj liste t’i kushtohet më shumë kujdes ngase mendoj se nuk është e analizuar mirë dhe nuk janë marrë parasysh emra dhe figura shumë më të rëndësishme se sa ata që janë aktual, e them këtë duke pas parasysh që kodet e reja të rrugëve që do të shtohen në të ardhmen do të emërtohen nga emrat që figurojnë në këtë listë.

z. Haki Rudari, theksoi, u tha këtu se komisioni ka pasur një punë të vështirë por që në fund ka rezultuar të jetë punë kryesisht e mirë, unë konsideroj se vet fakti që kjo punë është dashur të përfundon në muajin gusht 2014, ndërsa tani jemi në muajin shkurt 2015 tregon se nuk ka qenë edhe aq punë e kryer ashtu si duhet. Gjithashtu vlen të ceket se rreth emërimit të rrugëve në territorin e Komunës së Podujevës ka pasur edhe lajme të ndryshme nga mediat, ka pas edhe debate të “nxehta” brenda dhe jashtë komisionit si dhe ka pasur edhe interpretime dhe keqkuptime nga ana e një pjese të qytetarëve. Sa i përket anëtarëve të komisionit të cilët nuk janë këshilltarë të këtij Kuvendi mendoj se është dashur të ftohen në mbledhjen e KPF-së për arsye se kanë bërë një punë të madhe andaj edhe është dashur të jenë prezent dhe në dijeni për ndryshimet e disa emrave të disa rrugëve, ndryshime të cilat realisht është dashur të bëhen shumë herët nga ana e komisionit përkatës ngase tani mund të kemi pakënaqësi të mëdha nga ana e qytetarëve të cilët deri në ditën e mbledhjes së KPF-së kanë qenë në dijeni se rruga e tyre do të emërtohet ashtu siç ata kanë kërkuar kurse pas asaj mbledhjeje ai emërtim ndryshohet. Pra për kundër asaj se ndoshta është dashur që kjo punë të kryhet shumë më herët, unë prapë konsideroj se ky komision meriton një lëvdatë për punën e bërë.

z. Bashkim Statovci, theksoi, e ndiej për obligim ndaj familjeve të lagjes ku unë jetoj të them se me kohë e kam propozuar një emër për një rrugë, propozim i cilin me gjasë nuk është marrë në konsideratë nga komisioni apo nuk është shqyrtuar fare.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, e vërejta se ka lëvdata në adresë të komisionit për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës, megjithëse në rastet kur u është paraqitur ndonjë problem komisioni e ka menaxhuar shumë mirë, mirëpo unë kam argumente për defekte nga ana e këtij komisioni sepse në rastet ku nuk u është paraqitur kurrfarë problemi kanë bërë ndryshime duke ua humbur ose ndryshuar kuptimin emërtimeve të disa rrugëve.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, duke marrë parasysh punën aspak të lehtë të komisionit përkatës, mendoj se ka pasur edhe probleme dhe defekte të ndryshme dhe se të gjithë nuk janë të pajtuar me emërtimet e rrugëve ngase ka shumë pak rrugë në krahasim me emra të patriotëve, mësuesve dhe intelektualëve tanë të ndryshëm të cilët nuk kanë mundur të përfshihen të gjithë. Konsideroj se ky komision e kryer punën mirë, andaj ne

duhet ta miratojmë këtë propozim vendim me emërtime të rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës duke përfshirë edhe listën me emra rezervë. Edhe një çështje të cilën dua ta them është se ne si këshilltarë të Kuvendit duhet të krijojmë një kulturë në rastet kur ne si Kuvend themelojmë komisione të ndryshme të mos merremi me kritika vend e pavend, po ashtu vlen të ceket se edhe nga ana e disa anëtarëve të komisionit ka pasur kritika pa vend lidhur me emërtimet e rrugëve.

z. Kadri Avdiu, theksoi, nuk dëshiroj që të përfundon kjo pikë e rendit të ditës duke pasur ndokush gjëra të pasqaruara dhe të pakuptimta rreth punës së komisionit dhe emërtimeve të rrugëve por dëshiroj që të gjitha të sqarohen në këtë mbledhje sepse unë konsideroj se nuk është e rëndësishme të flasim sot rreth lëvdatave dhe pozicionimeve politike të anëtarëve të komisionit, por kemi të bëjmë me një dokument me vlerë shumë të rëndësishëm për të gjithë qytetarët pa dallime politike. Gjithashtu ne duhet ta kuptojmë edhe një gjë, se Komuna e Podujevës është Komuna me territorin më të madh në Republikën e Kosovës, si për nga numri i fshatrave ashtu edhe për nga numri i rrugëve, andaj ne të cilët jemi anëtarë të komisionit për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës nuk jemi duke thurur lëvdata për punën e këtij komisionit por jemi duke u munduar ta themi një të vërtetë për arsye se sot në këtë sall kemi edhe qytetarë dhe përfaqësues të mediave, andaj ne nga kjo mbledhje duhet të dalim me konstatime dhe argumente të sakta në mënyrë që të mos iu japim shkas qytetarëve për polemika dhe interpretime të ndryshme. E them këtë ngase ne si Kuvend duhet të jemi unik sa i përket këtij propozim vendimi dhe mos të përdorim gjuhën e pozitës ose opozitës, por qëllimi është që Komuna e Podujevës gjegjësisht Kuvendi i Komunës të mos del keq në opinion pastaj. Prandaj e përsërisë se nuk duhet keqkuptuar gjërat sepse çdo çështje e cila është në të mirë të qytetarëve nuk duhet të kemi dallime apo keqkuptime mes pozitës dhe opozitës së Kuvendit por duhet të jemi unik në rastet e marrjes së vendimeve të rëndësishme siç është ky për të cilin jemi duke debatuar, e që i vetmi lëshim që mund të përflitet është për disa lagje të caktuara të cilat kanë bërë presion ose që kanë këmbëngulur që rruga e tyre të emërtohet siç propozojnë ata vet, ku ne si komision nuk kemi dashur të shkaktojmë probleme dhe nuk kemi pasur mundësi të tejkalojmë ato propozime. Lidhur me çështjen që u tha nga disa këshilltarë se komisioni është vonuar pak sa në punën e tij, është e vërtetë që ka 10 muaj që kemi filluar me punë ne si Komision mirëpo duhet të kemi parasysh se jemi Komunë me një territor të madh dhe me një numër të madh të fshatrave dhe rrugëve, andaj ju lutem, nëse ne bëjmë krahasim me një Komunë siç është ajo e Obiliqit e cila i ka emërtuar rrugët në një afat më të shkurtë se ne, por që ajo Komunë përfaqësisht me territor është tri herë më e vogël se Komuna jonë. Nuk e konsideroj dështim vonesën ose kohëzgjatjen e punës së komisionit kur kemi parasysh arritjen e finalizimit të një dokumenti shumë pozitiv, sikurse që nuk e besoj se është mirë që sot të bëhen polemika dhe kritika të paargumentuara. Duke mos dashur të anashkaloj të drejtën e këshilltarëve për diskutim, kërkoj që njëzëri të votohet ky propozim vendim së bashku me rekomandimet e KPF-së, sepse vetëm ne jemi ata të cilët duhet ta pranojmë një punë e cila është bërë.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, e kuptoj plotësisht punën e vështirë dhe të mundimshme të komisionit, dhe e kuptoj se në rastet ku janë paraqitur probleme ato janë trajtuar mjaft mirë nga ana e komisionit, mirëpo në rastet ku nuk janë paraqitur probleme komisioni ua ka ndërruar kuptimin rrugëve.

z. Bahri Selimi, theksoi, mora fjalën për dy çështje, të gjitha rastet për të cilat unë kam bërë vërejtje dhe që kam dashur t'i them, i ceka në fjalimin tim të mëhershëm, mirëpo edhe një herë dua ta ngris çështjen e kohëzgjatjes së punës nga komisioni. Rreth asaj që z. Kadri Avdiu e tha se nuk është dështim kohëzgjatja e punës së komisionit, unë mendoj se pikërisht kohëzgjatja është dështim shumë i madh, e them këtë duke u bazuar në atë se në çoftë ne si komision do të takoheshim çdo ditë ose të paktën një herë në javë nuk do të ishte dështim, mirëpo ka ndodhur me një e dy muaj pa u takuar fare, andaj është gabim i madh nëse ne themi se kohëzgjatja e punës së komisionit nuk është dështim.

Sa i përket asaj që parafolësi e tha se në disa raste janë ndërruar emrat e rrugëve duke ua humbur kuptimin, e vërteta është se ju kemi kushtuar rëndësi shumë të madhe çështjeve më problematike dhe të ndjeshme që kanë qenë mes qytetarëve dhe familjeve të ndryshme lidhur me emërtimin e rrugëve ku jetojnë, raste të cilat i kemi trajtuar me kujdes të veçantë, ndërsa sa i përket rasteve ku nuk ka pasur vërejtje ne i kemi trajtuar në bazë të propozimeve që kanë ardhur nga qytetarët ku rreth 80% e emërtimeve janë si rezultat i propozimeve të marra në debate publike, rrugët për të cilat kanë pasur vetëm një propozim është mbetur ai propozim, kurse rrugët për të cilat ka pasur dy a më shumë propozime është e vërtetë se komisioni ka vendosë.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës së bashku me rekomandimet përkatëse. Gjithashtu konsideroj se të gjithë kemi një interesim të madh rreth emërtimeve të rrugëve në territorin e Komunës së Podujevës dhe disa prej këshilltarëve i thanë të gjitha ato që kanë pasur për t'i thënë rreth kësaj çështjeje, diskutime në bazë të të cilave mendoj se të gjithë jemi të pajtimit për ta votuar këtë propozim.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë po e vërej se nuk ka më të lajmëruar për diskutim, unë e përfundoj këtë pikë të rendit të ditës duke dhënë disa konstatime. Gjithashtu ne kemi diskutuar gjatë dy ditë më parë në mbledhjen e KPF-së, dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim këtë propozim vendim pjesë e të cilit është lista e emërtimeve të rrugëve sipas kodeve përkatëse, dhe lista e emrave rezervë prej 20% sipas rekomandimeve të cilat sot u janë dhënë në formë të shkruar të gjithë këshilltarëve të Kuvendit, vlen të ceket se në Komitetin për Politikë dhe Financa është ngritur një komision në të cilin kanë marrë pjesë edhe anëtarët që nuk janë pjesë e Kuvendit, pastaj komisioni është takuar dhe ka shqyrtuar edhe një herë listën e emërtimeve të rrugëve dhe listën me emra rezervë ku njëzëri nga ai komision janë bërë ndryshimet dhe plotësimet përkatëse të cilat janë përfshirë në rekomandimet përkatëse. Andaj konsideroj se çdo gjë është transparente sa i përket punës së komisionit përkatës sikurse që janë transparente edhe emrat e rrugëve, lista me emra rezervë, dhe nëse çdo gjë është e qartë unë e hedh në votim propozimin e këtij vendimi duke përfshirë dy listat përkatëse dhe rekomandimet Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimi u konstatua se me 33 vota për, 2 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozimi i vendimit për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, falënderoj organet e Komunës, komisionet përkatëse dhe zyrtarët që kanë punuar në këtë çështje si dhe të gjithë qytetarët për kontributin e dhënë, në përgjithësi i përgëzoj të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës që t'i gëzojnë emrat e rrugëve në territorit të Komunës së Podujevës.

5. Propozimi i Programit trevjeçar të banimit 2015-2017, në Komunën e Podujevës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në bazë të dispozitave të ligjit përkatës Ekzekutivi i Komunës është i obliguar të përgatitë programin trevjeçar të banimit i cili duhet të miratohet në Kuvendin e Komunës e më pastaj të dërgohet në Ministrinë përkatëse, edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është debatuar për këtë propozim program dhe janë dhënë disa vërejtje të cilat i janë rekomanduar Kuvendit.

z. Kadri Avdiu, theksoi, lidhur me këtë propozim program ne edhe në mbledhjen e KPF-së kemi debatuar dhe i kemi dhënë vërejtjet të cilat kanë të bëjnë me popullsinë në fshatra përkatësisht me komunitetet pakicë ku me siguri se ishte bartur një dokument më i vjetër e që nuk përkon me realitetin e tashëm. Propozoj të ndërhyhet dhe të kontrollohet edhe një herë ky dokument në mënyrë që ato pjesë të hiqen dhe të plotësohen me realitetin e tanishëm ngase ai dokument do të dërgohet i miratuar nga Kuvendi i Komunës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe pastaj mund të ndodh që të na dalin gjëra të paqarta, pra qëllimi i të gjithëve është që dokumenti të jetë i verifikuar mirë në mënyrë që të mos mbesin informata të gabuara në arkiva të institucioneve më të larta.

z. Bahri Selimi, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së në parim e përkrahim dhe mendojmë se është një program i qëlluar, mirëpo njëkohësisht i kemi disa vërejtje të cilat do t'i ceku në vazhdim, e të cilat i bëjmë me qëllimin më të mirë që ky program të jetë sa më i kompletuar dhe sa më i arsyeshëm; në disa vendbanime janë bërë disa lëshime sa i përket numrit të popullsisë, po ashtu lidhur me popullsinë në tabela të këtij dokumenti përveç komuniteteve rom, ashkalinj, egjiptian dhe serb thuhet, të tjerë, gjë për të cilën duam sqarime nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, shembull, në këtë dokument, në fshatin Dobërdol figuron një banorë serb për të cilin ne nuk jemi në dijeni se ekziston, mandej në fshatin Metergoc figurojnë shtatë banorë serb e që unë personalisht me anëtarët e Komitetit për Komunitete kemi vizituar atë fshat dhe ka vërejtur se janë vetë tre banorë të Komunitetit serb. Gjithashtu kemi vërejtje edhe sa i përket barazimit të shifrave gjë e cila nuk është bërë sepse ka mospërputhje të shifrave e që është e nevojshme të korrigjohen.

Pasta vërejtje tjetër të cilën do ta shtrojmë ka të bëjë me projektin e ndërtimit të shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, ku në një rast thuhet në këtë dokument se në fazën e parë për ndërtimin e 30 shtëpive Ministria ka ndarë 425,000.00 €, kurse unë posedoj informatën e komisionit për ndarjen e shtëpive në atë lagje në të cilën thuhet se në bazë të Memorandumit të nënshkruar në mes Kryetarit të Komunës dhe zëvendësministrit të Ministrisë përkatëse janë ndarë 420,000.00 €, e që është një diferencë prej 5,000.00 € gjë e cila do të ishte mirë të sqarohet a ka të bëjë me gabim teknik apo si qëndron kjo. Pra përkundër këtyre vërejtjeve që i ceka, ne si grup në parim e përkrahim dhe do ta votojmë këtë dokument.

z. Fidan Rekalii, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa janë dhënë gjitha këto vërejtje që u cekën deri më tani nga disa parafolës, mendoj se nuk kemi nevojë të stërzgjatim diskutimet rreth këtij dokumenti për shkak se të gjitha janë thënë në mbledhjen e KPF-së dhe i janë rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim me ato vërejtje. Ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë propozim plan.

z. Haki Rudari, theksoi, kolegu nga LVV-ja nuk e mohoi që këto vërejtje janë bërë në mbledhjen e KPF-së, por edhe pse janë bërë në atë Komitet nuk do të thotë se nuk bënë të përmenden edhe në Kuvend, sepse këtu jemi 35 këshilltarë dhe nuk arsyetohet ajo që u tha se këto vërejtje janë bërë në KPF dhe nuk duhet të përsëriten. Andaj edhe unë dua ti jap disa vërejtje rreth këtij programi. Në këtë dokument regjistrimi i popullsisë për Komunën e Podujevës i referohet viteve të nëntëdhjeta, ndërsa ne jemi në dijeni se ai regjistrim nuk është pranuar nga institucionet e Kosovës, pastaj lidhur me komunitetet thuhet, të tjerë, ky korrigjim duhet të bëhet sepse Drejtoria përkatëse iu ka referuar regjistrimit të popullsisë që është bërë në vitin 2011, shprehje për të cilën mendoj se është një gabim, gjithashtu në këtë dokument ceket ndërtimi i 10 shtëpive me karakter social për të cilat ne si Grup i LVV-së kemi vërejtje sa i përket ndarjes së atyre shtëpive sepse na janë paraqitur shumë ankesa nga qytetarët se ndarja e tyre vazhdimisht bëhet në bazë të përkatësisë politike, andaj kërkojmë që ndarja e tyre të bëhet sipas nevojave të qytetarëve e jo sipas bindjeve politike.

z. Flakron Gashi, theksoi, nuk dua të ndalem rreth të metave dhe mangësive që ka ky program, mirëpo kam një pyetje për ju zotëri Kryesues dhe për Ekzekutivin e Komunës. Sa është e ndershme që ne tani jemi duke diskutuar për një program të tillë, kurse drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale mungon në këtë mbledhje, dhe nuk mendoj se është e justifikueshme që drejtori të mungon duke u arsyetuar në një takim gjoja të rëndësishëm. Po ashtu pyes këshilltarët e Kuvendit, cili takim mund të jetë më i rëndësishëm; i Kuvendit, që përbëhet nga përfaqësuesit e 89.000 banorëve, apo ndonjë takim tjetër. Unë konsideroj se kjo është shmangie nga përgjegjësia si dhe sa i kotë dhe sa i pavlerë është ky program.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në mbledhjen e KPF-së i kemi identifikuar problemet e këtij dokumenti dhe si Komitet i kemi rekomanduar drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Mendoj se për këtë pikë të rendit të ditës nuk duhet të votohet sot sepse nuk bënë të miratohet një dokument i cili është i pa bazuar dhe se hartimi i tij është me të dhëna për natalitetin, nacionalitetin, popullatën e të tjera që i takojnë një regjistrimi shumë të largët, arsyeja tjetër është se drejtorit përkatës iu është dhënë detyra ta rifreskon këtë dokument dhe të na e dorëzon sot neve të harmonizuar dokumentin në mënyrë që sot të miratohet, mirëpo tani drejtori përkatës mungon dhe neve si këshilltarë nuk ka kush të na përgjigjet dhe të na jap sqarime rreth këtij dokumenti, andaj konsideroj që ky propozim program duhet të lihet për mbledhjen e radhës në mënyrë që të inkorporohen vërejtjet e bëra dhe ta kemi para vetës një program të qartë për miratim.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, e kam thënë disa herë se në këtë Kuvend është bërë një praktikë ku na paraqiten disa dokumente vetëm sa për t'i regjistruar në disa formularë të kësaj Komune si të miratuara, dokumente të cilat kërkohen, mirëpo fatkeqësisht këto dokumente nuk janë programe në bazë të të cilave do të bazohet puna e Ekzekutivit të Komunës, por janë dokumente të cilat vetëm do të mbeten në sirtarët e Komunës, dhe kam përshtypjen se edhe ky dokument është i tillë. Sa i përket seriozitetit të kësaj pune e ceken edhe parafolësit, se deri sa personat përgjegjës nga Ekzekutivi i Komunës nuk

janë prezent në sall kur debatohet për një program trevjeçarë, ska si të mos merret kjo punë si joserioze. Çështja tjetër që dua të them për hartuesit e këtij programi është se në raste të tilla kur kemi të bëjmë me hartimin e programeve të tilla duhet që ata persona të jenë profesionalisht më të ngritur ngase me shifra jo vetëm që mund të gabojmë por madje mund të dalim shumë qesharak, sikurse që në këtë dokument që ka shifra të bartura nga vitet e tetëdhjeta, si dhe konstatimi që me regjistrimin e popullsisë në vitin 1981 Komuna e Podujevës ka pasur 127,000 banorë. Pra mendoj se ky program është bërë vetëm sa për të thënë se është bërë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me mos prezencën e drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale unë edhe në më parë e ceka se drejtori më informoi se mund të ndodh që të mungoi në këtë mbledhje për shkak se një delegacion i Komunës së Podujevës sot do të udhëtoi për në Gjermani përkatësisht në qytetin Westestede ku përfaqësuesit e këtij qyteti kanë kërkuar projekte nga përfaqësuesit e Komunës së Podujevës me qëllim të gjetjes së mundësive për donacione, dhe sigurisht që drejtori është i zënë duke përgatitur ndonjë projekt apo diçka të ngjashme. Sa i përket këtij propozim programi është e vërtetë që z. Kadri Avdiu e tha se KPF-ja i ka rekomanduar Drejtorisë përkatëse që t'i harmonizon shifrat sipas regjistrimit të fundit që është zyrtarë duke u bazuar në Entin e Statistikave të Kosovës, po ashtu vërejtjet rreth numrit të regjistrimit të popullsisë të cilat i ceku z. Lutfi Rexhepi edhe ne i kemi bë dhe kemi rekomanduar të korrigojen. Diskutimet rreth këtij dokumenti janë të mirëseardhura dhe nëse sot miratohet ky dokument duhet të obligohet Drejtoria përkatëse që të gjitha vërejtjet e bëra t'i harmonizon me të dhëna zyrtare para se të dërgohet ky program në Ministri. Thënë të drejtën edhe unë jam befasuar që në këtë dokument thuhet se në fshatin Bajqinë ka komunitete tjera, mirëpo statistikave zyrtare qëndrojnë ashtu ngase ka martesat të ndryshme të deklaruara, kështu që unë mendoj se nuk ka ndonjë gabim ngase ashtu shihet në shikim të parë por ato të dhëna janë zyrtare dhe ne nuk mundemi t'i ndryshojmë. Meqë po e vërej se drejtori arriti të jetë i pranishëm unë ja jap fjalën nëse dëshiron të jap ndonjë sqarim, ose në të kundërtën vërejtjet e bëra janë të incizuara dhe mund të nxirren, dhe në bazë të tyre ky program mund të harmonizohet ose të korrigohet sa i përket gabimeve të mundshme.

z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, fillimisht kërkoj falje për vonesën, arsyet janë ato që Kryesuesi i tha. Sa unë kuptova është diskutuar për numrin e banorëve prej 127.000, por njëkohësisht në këtë dokument jepet edhe sqarimi se me regjistrimin e fundit që është bërë numri i banorëve në Komunën e Podujevës është 88.499 shifër kjo që konsiderohet si zyrtare.

Ky propozim program është punuar nga një grup punues prej tre anëtarëve, program i cili në bazë të ligjit për programet e veçanta të banimit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka kërkuar nga të gjitha Komunitet ta përgatitin dhe miratojnë në Kuvendet Komonale dhe pastaj të dërgohet në atë Ministri ku në bazë të këtyre programeve do të hartohet një strategji kombëtare e banimit trevjeçarë. Për përgatitjen e këtij programi kemi pasur një kohë bukur të shkurtër, megjithëse në muajin nëntor 2014 është mbajtur një trajnim për tre anëtarët e grupit punues, mirëpo me rëndësi është që ky program të miratohet sot sepse afat i dërgimit në Ministrinë përkatëse është 5 shkurt 2015, andaj kërkoj nga ju këshilltarë të Kuvendit që ta miratoni këtë program.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj që nëse drejtori parafolës ka dashur të jetë profesional por që nuk ka ditur, atëherë në këtë të dytën nuk mund ta gjykojmë, mirëpo nëse për dy ditë nuk ka arritur ta kryen punën kurse në anën tjetër kërkon të miratohet ky dokument për shkak se afati është i shkurtë, çështje që neve këshilltarëve të Kuvendit që jemi përfaqësues të qytetarëve shumë pak na brengosë afati i Ministrive apo i institucioneve tjera. Pjesë drejtorin parafolës, a është marrë parasysh rekomandimi i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe a është harmonizuar dokumenti përkatës me të dhëna zyrtare, dhe nëse ky dokument miratohet sot sipas rekomandimit të KPF-së kur do ta pranojmë ne si këshilltarë materialin e korrigjuar. Pra unë nuk e votoi një dokument në të cilin figurojnë statistika me përqindje për minoritetet që nuk janë ekzistuese dhe që nuk janë reale, dhe që nuk ka qenë asnjëherë në Komunën e Podujevës. Gjithashtu kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të mos bënë presion te këshilltarët e Kuvendit për ta votuar këtë dokument ngase nuk përmban të dhëna zyrtare dhe nuk është i harmonizuar me rekomandimet e KPF-së, mirëpo nëse miratohet sot, kërkoj nga Drejtori përkatës që në mbledhjen e radhës të më prezantoi programin final ashtu siç është dërguar në Ministri.

z. Flakron Gashi, theksoi, dëshiroj t'i drejtohem me një pyetje drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përgjegjësi e kujt ka qenë për ta hartuar këtë dokument, e juaja si drejtor i DSHMS apo përgjegjësi e Kuvendit komunal, dhe nëse është data e fundit 5 shkurti 2015 atëherë përse nuk është përgatitur më herët ky dokument. Konsideroj se kjo është papërgjegjësi e drejtorit të Drejtorisë së cekur dhe si praktikë e kësaj qeverisje e cila punët i lë për ditën e fundit, ashtu siç u informuam edhe për përgatitjen e projekteve sot sepse nesër kanë për tu prezantuar në Westerstede. Mendoj se nuk duhet të marrim parasysh presionin që ky dokument të miratohet sot me arsyetim se nesër duhet të dërgohet i miratuar në Ministri, e them këtë ngase përgatitja e këtij dokumenti ka qenë obligim i Ekzekutivit të Komunës e jo Kuvendi i Komunës, prandaj edhe përgjegjësia t'i mbetet Ekzekutivit të Komunës.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, dy parafolësit e thanë se po bëhet presion nga ana e ime për ta votuar këtë dokument. Me përgjegjësi të plotë ju them se kurrfarë presioni nuk bëra dhe nuk jam duke bërë dhe as nuk do të bëjë ndaj asnjë këshilltari të Kuvendit, votimi është lirë dhe si të dëshironi ju mund të votoni, por unë jam i obliguar me hedhë në votim, andaj konsideroj se nuk qëndron ajo që u tha.

z. Haki Rudari, theksoi, kur kemi të bëjmë me një pikë të rendit të ditës është mirë që zyrtarët nga Ekzekutivi i Komunës të jenë prezent dhe kërkoj që kjo vërejtje të jetë e fundit sa i përket kësaj çështjeje. Këtë propozim program dua ta ndërlihdhë me planin e punës së Kuvendit për vitin 2015 i cili është miratuar në fund të dhjetorit 2014 e që në të cilin është paraparë të mbahet një mbledhje në muajin janar kurse tani jemi në muajin shkurt 2015 dhe na kërkohet ta miratojmë një dokument i cili afatin e fundit për ta dërguar në Ministri e paska nesër, andaj nuk mund të themi se është në rregull dhe nuk mund të themi se kjo administratë është efikase kur kemi parasysh faktin që tani na thuhet se sot është afati i fundi që duhet të miratohet ky dokument, kurse në muajin janar nuk kemi mbajtur seancë e që ne si Grup kemi kërkuar të mbahet sepse kemi pasur të propozuara dy pika të rendit të ditës për muajin janar. Pra muaji janar është shkuar pa mbajtur mbledhje kurse tani jemi në pozitë ose të votojmë sot këtë propozim program ose mbetet pa miratuar dhe afati i fundit është nesër për të dërguar në Ministrinë përkatëse, prandaj për këto arsye ne si Grup i LVV-së do të votojmë kundër.

z. Naim Çunaku, theksoi, edhe në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar rreth këtij propozim programi dhe i kemi rekomanduar Kuvendit ashtu si në materialet që i morëm para fillimit të kësaj mbledhjeje, konstatimi është që rekomandimet të jenë pjesë e këtij programi. U bënë shumë vërejtje, se në mese të caktuara përqindja e popullatës nuk përkon me realitetin, dhe ne para vetës kemi një dokument i cili për mendimin tim ka një të metë sepse nuk tregohet bazueshmëria e regjistrimit të popullsisë, e që mendoj se është sipas regjistrimit të fundit. Ne mund të hamendemi me këto të dhëna që në meset tona kemi përbërje të ndryshme, mirëpo gjatë regjistrimit të popullsisë deklarimet janë personale, kështu që me apo pa dëshirë mund të kemi edhe komunitete tjera në mese tona për të cilët ndoshta nuk jemi në dijeni. Sa i përket vërejtjes që u bë për marrjen për bazë të regjistrimit të popullsisë në vitin 1990, si dhe numër i banorëve 130.000 i cili po kalkulohet e në bazë të të cilit kemi punuar edhe ne si Komunë deri në regjistrimin e ri më 2011, mendoj se është numër përafërsisht i njëjtë me atë të regjistrimit të fundit të popullsisë po që se marrim për bazë edhe numrin e banorëve jorezidentë të Kosovës. Pra kur kemi të bëjmë me plane të ndërtimeve ne duhet të kemi parasysh një element që është specifikë e Kosovës ngase ne kemi një popullatë e cila jeton në vende të ndryshme të botës e që janë banorë jorezidentë të Kosovës dhe të mos harrojmë se ata banorë kanë investime, banesa, shtëpi e të tjera, të cilat duhet të jenë në përputhje me planet tona zhvillimore, dhe nuk bënë të përjashtohen sepse kanë pasuri në Kosovë, mendoj se pikërisht këtu ndoshta ka qenë mirë që programi të ketë një qasje më heterogjene dhe të përfshihen edhe banimet e atyre banorëve. Sa i përket këtij dokumenti, sa unë kuptova nuk është i përgatitur për udhëtim zyrtarë por është për institucionet qendrore, dhe meqë afati është i limituar nuk dëshiroj që Komuna jonë të mbetet pa program trevjeçar të banimit, mirëpo bashkë me miratimin e këtij programi me automatizëm t'i adresohet edhe vërejtja drejtorit përkatës që në të ardhmen të jetë më syçelë rreth afateve kohore.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, për të mos krijuar ndonjë huti nga diskutimi im i mëparshëm, dua të citoj se çka thuhet në këtë dokument, sipas regjistrimit të viti 1981, e që është regjistrim zyrtar, Komuna e Podujevës kishte 127.376 banorë, ndërsa në regjistrimin e fundit më 2011 numërohen 88.499 banorë, pra këtu flitet për dy regjistrime zyrtare. Çështje tjetër në këtë dokument thuhet, e tërë pjesa veriore dhe lindore kufizohet me republikën e Serbisë me një gjatësi kufitare prej 175 km e 200 m, kurse më pastaj thuhet, me republikën e Serbisë gjatësia është 90.9 km, pra kemi shpërputhje mes numrave. Po ashtu sipas tabelave në këtë dokument shfrytëzimet e tokave të punueshme dhe sipërfaqet e banimeve i kemi të ngjashme sikurse në vitet e nëntëdhjeta, andaj nuk kemi kurrfarë ndryshimesh, por vetëm barten këto të dhëna me dekada në dokumente të tilla.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, çështjet që i ngriti z. Naim Çunaku ne edhe në KPF i kemi thënë dhe e kemi obliguar Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ta korrigjon ose të bëjë ndryshim plotësimin e dokumentit me të dhëna zyrtare aty ku paraqitet nevoja. Konsideroj që nëse ky dokument miratohet sot, gjithsesi se do të harmonizohet në bazë të shënimeve dhe të dhënave zyrtare para se të dërgohet në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, andaj e hedhë në votim.

Pas votimit u konstatua se me 19 vota për, 4 vota kundër dhe 10 vota të përmbajtura, u miratua Propozim programi trevjeçar i banimit 2015-2017, në Komunën e Podujevës.

6. Propozimi i vendimit për mbështetje financiare OJQ-në HANDIKOS – Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi në Podujevë

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ky propozim vendim është bërë në bazë të kërkesës së OJQ-së Handikos – Podujevë për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të kësaj organizate, konsideroj se të gjitha arsyetimet janë të specifikuar në materialin që iu është dërguar. Vlen të ceket se edhe vitin e kaluar kjo organizatë është mbështetur me të njëjtën shumë buxhetore dhe ka arritur t'i përmbush me sukses objektivat dhe aktivitetet e veta.

z. Fidan Rekalii, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim fuqishëm këtë propozim vendim, ne bashkërisht edhe me përfaqësuesit e Partisë Demokratike të Kosovës të njëjtën gjë e kemi bërë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa ku të gjithë kemi votuar për dhe i kemi rekomanduar kuvendit për shqyrtim dhe miratim të këtij propozim vendimi përveç përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje i cili ka abstenuar.

z. Naim Çunaku, theksoi, është e vërtetë ajo që e tha parafolësi në lidhje me rekomandimin që është bërë nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës e mbështesim këtë propozim vendim për ndarjen e mjeteve buxhetore për OJQ-në Handikos – Podujevë.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo pas vizitës që ne si Grup i kemi bërë kësaj qendre mund të themi se kjo shumë e mjeteve ndoshta është e pamjaftueshme për nevojat e tyre. Gjithashtu ne si Grup kërkojmë që ngjashëm me këtë ndihmë që i bëhet OJQ-së Handikos, t'i mundësohet ndihma edhe nënave lehona, kërkesë kjo e ngritur për afërsisht qe një vit ku sipas statistikave të marra nga shtëpia e shëndetit në Podujevës gjegjësisht në maternitet në vitin 2014 kanë lindur 72 nëna, e që nëse do të ndanim nga 100.00 € i bie 7,200.00 € për një vit, shumë e cila për buxhetin e Komunës do të ishte e përbalueshme. Konsiderojmë se po të kurseheshin mjetet buxhetore nga drekat, darkat, telefonitë mobile dhe gjëra tjera luksoze, sigurisht se do të mund të realizohej kërkesa jonë për stimulimin e nënave lehona.

z. Bahri Selimi, theksoi, edhe përkundër vërejtjeve që i paraqiti parafolësja ne në parim e mbështesim dhe e përkrahim fuqishëm këtë propozim vendim. Mendoj se shuma e mjeteve e ndarë si viteve të kaluara ashtu si në këtë vit për OJQ-në Handikos është e qëlluar, mirëpo pyes Ekzekutivin e Komunës se a është ndërmarrë ndonjëherë diçka nga Komuna për fëmijët e prekur me sindromin down, ku sipas informatave që kam në Komunën e Podujevës është një numër bukur i madh i atyre fëmijëve dhe nuk ka shoqatë të themeluar për këta fëmijë, e që ndoshta jemi ndër Komunitat e pakta në Kosovë që nuk ekziston ajo shoqatë, nuk ndahen mjete buxhetore dhe asnjëherë nuk është treguar përkujdesje për këta fëmijë. Meqë ne po ndajmë mjete buxhetore për OJQ të ndryshme, ne si Grup kemi kërkuar edhe më parë dhe prapë mendojmë se edhe kategorive të dala nga lufta duhet t'ju ndahen mjete buxhetore sepse edhe ato janë OJQ dhe kanë nevojë për mbështetje nga ana e Komunës.

z. Nexhmi Rudari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, sa i përket çështjes që ka të bëjë me fëmijët e prekur me sindromin down, dua të jap një sqarim, Komuna e Podujevës ka një bashkëpunim të mirë me Shoqatën Down Sindrom Kosova e cila është në nivel të Kosovës dhe selinë e ka në Prishtinë, kurse të gjithë fëmijët e Komunës së Podujevës të

cilët janë të prekur me sindromin down janë të përfshirë në shkollimin e nxënësve me nevoja të veçanta si dhe të njëjtit janë të përfshirë në kuadër të OJQ-së Handikos – Podujevë.

z. Haki Rudari, theksoi, përfaqësuesi nga radhët e LDK-së e tregoi rezultatin e votimit që është bërë në KPF për këtë pikë të rendit të ditës. Unë mund t'iu siguroj se këtë propozim vendim e kam përkrahur në parim dhe besoj se është evidentuar në procesverbal, mirëpo i kam dhënë vërejtjet e mia për arsye se nuk jam për të krijuar hipokrizi, që dikush të ndihmohet e dikush jo, e them këtë ngase disa ndihmohen duke i manipuluar me vota, kurse nuk ndihmohen ata nga të cilët nuk merret vota, andaj kam qenë kundër kësaj në parim. Ne si Grup dje e kemi vizituar OJQ-në Handikos në Podujevë, dhe jemi pritur nga menaxheri i kësaj Organizate, vërtetë ata persona kanë shumë probleme, vërejtje, dhe shumë kërkesa, konsideroj se nuk mjafton shuma e kërkuar sipas këtij propozim vendimi. Unë kam marrë një telefonat nga një familje nga fshati Majac të cilët kanë pasur problem në lidhje me transportin e nxënësve me nevoja të veçanta të cilët vijojnë mësimet në shkollën e fshatit Gllamnik, kështu që OJQ Handikos ka probleme të shumta dhe Grupi jonë vazhdimisht ka qenë dhe do të jetë atje ku paraqiten nevojat dhe rastet e ndryshme të qytetarëve. Prandaj është mirë që në raste të tilla të flitet më me korrektësi.

z. Fidan Rekalju, theksoi, atë që e thash më parë ashtu edhe qëndron, ja rikujtoj parafolësit se në konstatime të rekomanduara nga Komitetit për Politikë dhe Financa, të cilat i morëm të gjithë këshilltarët para kësaj seance, për këtë propozim thuhet, pas votimit Kuvendit me 10 vota për dhe një votë të përmbajtur i rekomandohet për shqyrtim.

z. Kadri Avdiu, theksoi, mendoj se me kategorinë e personave me nevoja të veçanta nuk kemi nevojë të bëjmë elaborime. Mund të them se nevojat janë evidente edhe për njerëzit e papunë që ne mund të japim propozime dhe tua ndajmë edhe atyre nga 200 € prej buxhetit të Komunës, mirëpo mundësitë janë ato që janë, andaj më së paku ne kemi nevojë që për kategoritë e njerëzve me nevoja të veçanta të bëjmë proklamime politike, sepse asnjë organizatë dhe asnjë institucion nuk mund të krahasohet me personat me nevoja të veçanta apo OJQ-në Handikos. Pra po e përsëris se nuk kemi nevojë të bëjmë politikë me këtë çështje por duhet të jemi të ndjeshëm për kategori dhe të mundohemi të gjejmë edhe mënyra tjera për t'i ndihmuar me shuma më të mëdha, e lëre më të vihet në pikëpyetje shuma e kërkuar nga ajo organizatë.

z. Haki Rudari, theksoi, unë bëj pyetje, si po gjenden mjete financiare për këto organizata kurse për stimulimin e nënave lehona nuk po gjenden kur kemi parasysh që në bazë shënimeve që ne si Grup i kemi marr në vitin 2014 kishte 72 lindje e që bie përafërsisht 7,200.00 € në vit, kështu që nuk është ndonjë shumë e madhe ose e papërbalueshme për Komunën tonë por vetëm mungon vullneti, pra kjo është arsyeja që unë në KPF e kam përkrahur në parim por kam abstenuar sepse nuk votoj dhe nuk propozoj të jem pjesë e diçkaje ku krijohet një hipokrizi.

z. Naim Çunaku, theksoi, zotëri Kryesues, me Rregullore të Punës së Kuvendit nuk lejohet që këshilltarë të Kuvendit të përdorin fjalë fyese ndaj kolegëve të tyre. z. Haki Rudari e përmendi fjalën hipokrizi në diskutimin e tij më parë mirëpo unë e konsiderova se ajo shprehje i rrëshqiti, por i njëjti e përsëriti edhe herën e dytë fjalën hipokrizi. Nëse ne dëshirojmë ta sqarojmë se kush është duke bërë lojë hipokriti duhet ta kemi parasysh se jemi të gjithë përfaqësues të qytetarëve dhe të gjithë neve na dhemb shpirti për qytetarët e Kosovës, andaj nuk pajtohem që ndokush këtu të mundohet ta merr primatin si të jetë kujdestarë i ndonjë kategorie ose ndonjë organizate, ose të mburret dikush këtu

për propozimet që bënë, andaj mendoj se këto janë lojëra të cilat nuk duhet të bëhen. Pra fjala hipokrizi duhet të tërhiqet sepse ne që votojmë për nuk jemi hipokrit, çka kupton këshilltari i cekur me atë fjalë nuk di por unë konsideroj se fjala hipokrizi për mua personalisht dhe për këshilltarët është fjalë fyese. Gjithashtu po i njëjti këshilltarë e keqpërdori foltoren duke përmendur shprehjen koalicion i heshtur e që unë mendoj se nuk është ai i cili duhet të merret me këto gjëra sikurse që u mor me dy subjektet, LDK dhe PDK që e mbështetën këtë propozim vendim kurse ai në një formë na quajti hipokrit, pse ne u deklaruam se e përkrahim këtë propozim.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, mendoj se shuma e propozuar në këtë propozim vendim është shumë e vogël në raport me nevojat që kanë kjo kategori e njerëzve, unë personalisht njohë njerëz të kësaj kategorie të cilëve iu është ndalur edhe asistenca invalidore, andaj mendoj se kjo organizatë duhet të mbështetet nga Komuna e Podujevës dhe t'iu krijohen kushtet që çdo rast veç e veç brenda territorit të Komunës të jetë në përkujdesje të vazhdueshme në mënyrë që ata persona të mos mbesin barrë e familjeve të tyre por të kenë adresë e cila iu ndihmon atyre në mënyrën më normale të mundshme. Unë askënd nga këshilltarët nuk e arsyetoj nëse mendon që këtë kategori ta barazoi me ndonjë kategori tjetër sociale.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, në asnjë formë nuk e shoh të arsyeshme që kjo organizatë dhe këto kategori të njerëzve me nevoja të veçanta të barazohen me organizata dhe kategori tjera, pavarësisht që jemi në dijeni se kanë nevoja të shumta edhe shumë organizata tjera siç janë organizata e Veteranëve të Luftës, invalidëve, minatorëve e të tjera, mirëpo kategoria e njerëzve me nevoja të veçanta është e veçantë, andaj nuk duhet të bëjmë polemika për këtë çështjeje, por të përkrahim këtë kategori edhe më shumë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jua rikujtoj të gjithë këshilltarëve se ne si Kuvend i Komunës e kemi të miratuar Rregulloren e Punës së Kuvendit të cilës duhet ti përmbahemi. Kërkoj nga të gjithë që të respektohet Rregullorja dhe Kodi i Mirësjelljes dhe të mos përdoren fjalë fyese sepse atë nuk do ta lejoj unë si Kryesues.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i vendimit për mbështetje financiare OJQ-në HANDIKOS – Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi në Podujevë.

7. Propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para se të kalojmë me debat dua të jap një sqarim rreth këtij propozimi me të cilin propozohet që dy pjesë të pronave t'i jepen në shfrytëzim Kompanisë së cekur me qëllim të investimeve gjegjësisht vendosjen e dy transformatorëve, njëra në fshatin Letanc kurse tjetra në fshatin Lupç të Poshtëm ku për këtë të dytën ne në mbledhjen e kaluar kemi marr një vendim të tillë mirëpo Kompania KEDS nuk e ka pranuar me arsyetim se nuk dëshiron të paguaj kompensimin, pastaj kjo kompani ka bërë prapë kërkesë që ato dy prona t'i jepen në shfrytëzim pa kompensim ose siç ka deklaruar tërhiqet nga investimet, pastaj në anë tjetër komunitetet e atyre dy fshatrave kanë nevojë për përmirësim të rrjetit dhe furnizim

më cilësorë me energji. Ne në KPF kemi diskutuar për këtë dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim ashtu siç e keni në konstatime.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj se kësaj pike të rendit të ditës duhet t'i kushtohet rëndësi të veçantë sepse kemi të bëjmë me dhënie të pronës publike në shfrytëzim, mirëpo duhet pasur parasysh edhe nevojën për dy transformatorë të ri në ato dy lokalitetet përkatëse. Jemi në dijeni se në mbledhjen e kaluar të Kuvendit kemi miratuar një vendim me rekomandim të Kryesuesit dhe të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë që shuma e kompensimit të jetë 5 € për 1m², mirëpo ky vendim nuk është pranuar nga KEDS-si, çështje tjetër që dua ta them është se neve na është ardhur një propozim për dhënien në shfrytëzim për 99 vite të dy pronave, propozim i cili mendoj se është bërë pa e shikuar ligjin fare, pastaj në KPF kemi rekomanduar Kuvendit që pronat të jepen në shfrytëzim për 40 vite, prona të cilat nuk janë të publikuara në ueb – faqe zyrtare e që është e obligueshme. Mendoj se para vetës kemi një propozim vendim i cili për mendimin tim është në kundërshtim me ligjin dhe me këtë keqpërdoret prona publike sepse KEDS është kompani private e përkohshme e cila inkason mjete nga vendosja e atyre transformatorëve në ato prona, andaj nuk mendoj se është mirë që ne të votojmë sot këtë propozim sepse me këtë pronat publike i lëmë hipotekë për 40 vite te një kompani për të cilën nuk jemi në dijeni të plotë se si është kontraktuar. Ne kemi edhe rastin e dhënies në shfrytëzim të një lokali në qendër të qytetit ku fituesi i atij lokali ka bërë ndërhyrje duke e thyer shtyllën kryesore dhe duke e ndarë lokalin në dysh dhe duke lëshuar njërin me qera për afërsisht me shumën që i paguhet Komunës, pastaj kemi lokalin tjetër në qytet, ish hotel Llapi, për të cilin mendoj se ka pas keqpërdorime sepse çmimi ka qenë shumë i ulët dhe nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim. Prandaj konsideroj se nuk mundemi ne sot të shfuqizojmë një vendim të Kuvendit sipas së cilit KEDS-it një muaj më parë i është dhënë prona Komunale në shfrytëzim me kompensim, kurse në anën tjetër sot para vetës kemi një propozim të Kryetarit të Komunës për të njëjtën çështje, vetëm pa kompensim dhe për dy prona. Andaj lidhur me këtë kërkoj që edhe nëse votohet sot ky propozim vendim, të respektohet neni 6 i ligjit për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim përkatësisht afat i dhënies prej 99 viteve.

Gjithashtu kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë që në mbledhjen e radhës të mi prezanton të gjitha kontratat e lidhura në mes Kryetarit të Komunës dhe kompanive për pronat e dhëna në shfrytëzim nga Kuvendi i Komunës.

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, dëshiroj të jap një sqarim lidhur me nenin 10 të ligjit për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, në të cilin thuhet, dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës për raste të veçanta, pastaj paragrafi 1.5 e ceke, dhënia e pronës së paluajtshme në shfrytëzim me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë, e njëjta thuhet edhe në Rregulloren e QRK 23/2013, Kuvendi i Komunës vendos për dhënien e pronës në shfrytëzim me kompensim ose pa kompensim. Është e vërtetë që Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e datës 14 nëntor 2014, në kërkesë të KEDS-sit dhe komunitetit të fshatit Lupç i Poshtëm, ka marrë vendim me të cilin është dhëna prona prej 4m² në shfrytëzim me kompensim, për vendosjen e transformatorit, mirëpo KEDS ka hequr dorë nga ai vendim duke u arsyetuar me mos pagesë të qerasë ngase vendosja e transformatorëve është në interes të banorëve, por të njëjtën kohë KEDS

dhe banorët e fshatrave Letanc dhe Lupç i Poshtëm kanë bërë kërkesë të përbashkët që pronat përkatëse të cekura në propozim vendim t'i jepen KEDS-it në shfrytëzim. Sa i përket shfuqizimit të vendimit të mëparshëm, mendoj se është shumë e qartë sepse në nenin 9 të këtij propozim vendimi thuhet, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës nr. 01-463-92251 i datës 14 nëntor 2014. Ndërsa sa i përket publikimit në ueb-faqe zyrtare të Komunës të pronave të paluajtshme të Komunës, nuk është e nevojshme kjo të bëhet kur kemi të bëjmë me dhënien në shfrytëzim për raste të veçanta, sepse nuk ka konkurrim për këto raste.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, mendoj që këtij Kuvendi duhet t'i prezantohen kërkesat e qytetarëve në mënyrë që të rishqyrtohen ato kërkesa dhe baza ligjore e tyre. Gjithashtu mendoj dhe mund të ndodh që këto dy prona komunale për të cilat jemi duke debatuar të jenë prona publike të pashfrytëzuara, gjë e cila nuk do të ishte e drejtë në çoftë se pronat e tilla nuk lejojmë të vihen në shërbim dhe për nevoja të komuniteteve. Sa i përket funksionimit të kompanisë KEDS, besoj se të gjithë jemi në dijeni se si funksionon ajo kompani dhe si është privatizuar në mënyrë të kriminalizuar dhe që nuk është aspak e përgjegjshme në raport me qytetarët. Pastaj nëse ne nuk e miratojmë këtë propozim vendim, KEDS me siguri se banorëve të fshatrave Lupç i Poshtëm dhe Letanc do t'iu thotë se Kuvendi i Komunës nuk ka miratuar kërkesat e juaja dhe ato të KEDS-it, pra me këtë pësojnë qytetarët. Nuk është faji jonë këtu sepse ne nuk kemi mekanizma për t'i mbikëqyrur shërbimet e ndërmarrjeve publike ose kompanive të tilla mirëpo kemi mekanizma që kërkesat e qytetarëve t'i shqyrtojmë dhe t'i miratojmë në mënyrë që sado pak t'jua lehtësojmë jetën atyre.

z. Bahri Selimi, theksoi, kërkesat e qytetarëve vërtetë se duhet të respektohen dhe të realizohen me përpikëri, mirëpo ta kemi të qartë se sot kemi një kërkesë nga një kompani e cila është private. Konsideroj se ky propozim ka të bëjë me dhënien e pronave komunale në shfrytëzim një kompanie e cila do të gjeneroi mjete financiare nga qytetarët përmes atyre transformatorëve të cilët parashihen të vendosen në ato prona publike, ndërsa sa i përket asaj që dikush nga parafolësit e tha se kemi të bëjmë me kërkesë të qytetarëve, mendoj se kjo nuk ka të bëjë fare me kërkesë të qytetarëve, por ka të bëjë me kërkesë të kompanisë KEDS e cila është private dhe e cila kërkon pronë pa kompensim për vendosje të transformatorëve, dhe e cila në njërin anë inkason mjete financiare nga qytetarët kurse në tjetrën anë thirret në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Andaj propozimi im është që pronat përkatëse t'i jepen në shfrytëzim kompanisë KEDS me kompensim dhe në një afat deri në 15 vite.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, fillimisht dëshiroj të them se në çoftë se ndokënd e kam rënduar nga fjalimi im i mëparshëm, unë e tërheqë fjalën. Të jemi të qartë, nuk e thash se pronat përkatëse duhet të jepen pa kompensim, mirëpo aludova në atë se në tregun e Kosovës e kemi vetëm një kompani e cila ofron produkte të energjisë elektrike dhe nëse qytetarët nuk gjejnë zgjidhje të problemeve të tyre tek kjo kompani sa i përket furnizimit cilësorë me energji elektrike, sigurisht se ata mbeten pa energji. Pastaj unë e thash se të gjitha kërkesat e qytetarëve duhet të trajtohen, si dhe e ceka se kemi prona publike në fshatra dhe lagje tona, të cilat sigurisht se e kanë vlerën e tyre, mirëpo që nuk janë të shfrytëzuara. Pra nuk është mirë që ne të mos i sakrifikojmë 4-5 m² për një tarifë të caktuar, kurse në anën tjetër t'i lëmë një komunitet të tërë pa energji elektrike.

z. Bahri Selimi, theksoi, më bëri përshtypje ajo që u tha këtu se, për fajin e Kuvendit të Komunës mund të mbetet një territor i caktuar pa energji elektrike, andaj si ka mundësi që një kompani e cila me privatizim parashihet të bëjë investime në rregullimin e rrjetit energjetik dhe jam i sigurt se në atë kontratë nuk thuhet se nëse ndonjë Kuvend i ndonjë Komune nuk e jep pronën në shfrytëzim për kompaninë KEDS, qytetarët do të mbeten pa energji elektrike. Prandaj të jemi të qartë se ajo kompani është private dhe është e obliguar të rregulloj rrjetin e energjisë elektrike për qytetarët ngase ajo kompani gjeneron edhe mjete financiare nga qytetarët.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, besoj se jemi në dijeni se KEDS është kompani private e cila është privatizuar për 25 vite, kurse në këtë propozim vendim parashihet t'i jepet prona në shfrytëzim për 40 vite. Gjithashtu ajo kompani me kontratë obligohet të bëjë investime, dhe nuk kemi nevojë të kemi frikë nga investitorët ngase ata janë të obliguar ta zbatojnë gjithsesi kontratën. Mirëpo nëse KEDS nuk e zbaton kontratën për arsye se ne si Kuvend nuk e miratojmë këtë propozim që t'ia japim pronën në shfrytëzim pa kompensim, atëherë ne duhet të bëjmë padi kundër kësaj kompanie. Sa i përket asaj që një këshilltarë më parë e tha se duhet të kemi frikë nga qytetarët nëse nuk e miratojmë këtë propozim sepse ata qytetarë do të mbeten pa energji elektrike dhe do të na bëjnë fajtor neve si Kuvend, mendoj se qytetarët nuk kanë nevojë të na akuzojnë neve si këshilltarë të Kuvendit për një kompani private e cila ka për obligim për investime në rrjetin e energjisë elektrike dhe shpërndarjen e saj.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, përfaqësuesi nga LDK-ja gjatë diskutimit e bëri një konstatim duke thënë se jemi në dijeni se KEDS është privatizuar në formë kriminale apo korruptive, e që unë besoj se ky konstatim është i gjithë LDK-së ngase e tha një zyrtarë i lartë i këtij subjekti, por meqë Kryeministri i Kosovës është nga radhët e LDK-së, shpresoj që Qeveria e Kosovës të merret me hetimin e privatizimit të KEDS.

Sa i përket këtij propozim vendimi, ne në një mbledhje të kaluar e kemi miratuar kërkesën e kompanisë KEDS për dhënien e një pjese të pronës në shfrytëzim në fshatin Lupç i Poshtëm, kërkesë e cila nuk ka të bëjë me komunitetin por është kërkesë e KEDS kompani kjo e cila është profitabile, andaj është shumë normale të kërkojmë kompensim për një pronë të Komunës të cilën pretendojmë të japim në shfrytëzim, dhe unë nuk vërejtja vullnet nga askush që mos t'i jepen KEDS-it ato prona në shfrytëzim, mirëpo jo t'ia falim, sepse as qytetarëve nuk iu falet asgjë.

Çështja tjetër që dua të ngritë, ka të bëjë me drejtorin e Drejtorisë së Kadastrit dhe Gjeodezisë, për të cilin mendoj se nga njëherë është duke na ngutur dhe duke na bërë presion neve si Kuvend, ku ne si këshilltarë nuk po mundemi të vijmë në një përfundim të saktë për çështje të caktuara, dhe si pasoj e asaj mund të marrim vendime ndoshta jo të drejta, siç e kemi pasur rastin e pronës komunale në fshatin Sallabajë të cilën e kemi dhënë në shfrytëzim duke na thënë se kemi të bëjmë me investime milionëshe, kurse në fakt deri tani nuk është bërë asgjë. Kështu që kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së cekur që në mbledhjen e radhës ta përgatit një listë të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat janë në pronësi të Komunës, dhe gjendjen e tyre, në mënyrë që ne këshilltarët e Kuvendit të Komunës ta kemi në dispozicion, e kërkoja këtë sepse mund të ndodh që për prona të caktuara të mos kemi njohuri të mjaftueshme ne si këshilltarë gjë që na e vështirëson edhe votimin pastaj.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, me parafolësin kam qenë në një subjekt politik dhe e respektoj shumë atë, mirëpo sa i përket diskutimit tim të mëparshëm dua ta sqaroj se, unë nuk diskutova dhe nuk e mora fjalën për ta përfaqësuar një Grup të këshilltarëve të Kuvendit, gjithashtu nuk e thash se qëndrimi im është edhe qëndrim i Grupit të LDK-së sepse nuk jam shef i Grupit. Jua rikujtoj se ne jemi përfaqësues të qytetarëve dhe secili i kemi marrë votat individualisht. Në këtë kontekst besoj se unë e përfaqësoi një parti shumë demokratike e cila e respekton fjalën e lirë të të zgjedhurit të popullit. Sa i përket privatizimit që është bërë në Kosovë, unë plotësisht e mbaj përgjegjësinë për fjalët që i them, dhe ky është qëndrim i imi individual, por nuk është i subjektit ashtu siç e tha parafolësi. Çështje tjetër rreth kësaj pike, unë nuk kërkova që prona komunale t'i jepet kompanisë KEDS pa kompensim, por e thash që banorët e atyre lokaliteteve fillimisht kanë bërë kërkesë në KEDS, pastaj kjo kompani atë kërkesë e ka drejtuar për miratim në këtë organ vendimmarrës me qëllim të ofrimit të shërbimeve për qytetarë.

z. Haki Rudari, theksoi, lidhur me privatizimin e distribucionit të furnizimit me energji elektrike për të cilin u tha se ka pasur të meta mendoj se janë në dijeni të gjithë qytetarët, jemi në dijeni se vazhdimisht janë duke u bërë protesta nga qytetarët kundër KEDS. Drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë e tha se ndoshta KEDS nuk paguan qera. Ju njoftoj se Kuvendi i Komunës së Gjakovës njëzëri ka votuar një kërkesë për KEDS rreth orëmatësve të cilat i kanë vendosur në shtylla, kështu që mendoj se në raste të tilla të ndjeshme nuk kemi nevojë të ngutemi në marrjen e vendimeve por duhet t'i shqyrtojmë ato me kujdes sepse kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me qytetarët përfaqësues të të cilëve jemi ne. Arsyeja që Grupi i LVV-së këtë propozim vendim e voton kundër është, afati prej 99 vitesh dhe dhënia në shfrytëzim e pronave pa kompensim. Pra nuk guxojmë që ne të biejmë pre e shantazheve të asnjë kompanie, dhe as nga KEDS e cila kërkon që prona t'i jepet në shfrytëzim pa kompensim, përndryshe thotë se nuk do të investoi.

z. Naim Çunaku, theksoi, pjesa dërrmuese e diskutuesve shfaq si element kryesorë që duhet të kundërshtohet kohëzgjatjen e dhënies në shfrytëzim të pronave përkatëse, mirëpo nuk jam në dijeni se a e kanë vërejtur se në konstatime të KPF-së qartësohet mirë se KPF i ka rekomanduar Kuvendit që pronat përkatëse të jepen në shfrytëzim për 40 vite, ndërsa sa i përket dhënies në shfrytëzim me apo pa pagesë unë dua ta shpreh një qëndrim timin personal, gjithçka që do të mundim të shesim apo të japim me qera nga të cilat do të inkasoheshin të hyra për Komunën do të ishte e mirëseardhur, sikurse që ishte rasti i marrjes së vendimit në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2014 ku pothuajse njëzëri votuam që KEDS-it një pjesë e pronës së Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm t'i jepet në shfrytëzim me kompensim me qëllim që të krijojmë të hyra vetanake për Komunën. Lidhur me privatizimin e KEDS e cila u ngrit dhe pati polemika mes disa këshilltarëve parafolës, konsideroj se të gjithë ata të cilët kanë informata apo që mund të kenë për keqpërdorime në lidhje me privatizimet që janë bërë në Kosovë, është vendi se ku duhet të deponohen ato informata, unë personalisht do të doja që të gjitha ata persona që kanë bërë manipulime ose keqpërdorime në çfarëdo aspekti, qoftë me prona qoftë me privatizime e të tjera, të ballafaqohen me organet e drejtësisë dhe do të isha një prej atyre personave më të lumtur në çoftë se e vërej se defektet e tilla do të eliminoheshin.

Pra ne jemi para një situatë ku kompania KEDS refuzon të paguan qera për pronën të cilën e ka kërkuar për shfrytëzim nga Komuna, është e drejtë ajo që ne këtu mund të

themi se çka ka rëndësi ajo shumë e vogël e mjeteve financiare e qerasë për një kompani siç është KEDS e cila është profitabile dhe me të hyra të mëdha, mirëpo të kemi parasysh që i gjithë rrjeti dhe të gjitha shtyllat janë të vendosura në prona të dikujt kryesisht në prona private të njerëzve, andaj me siguri se edhe KEDS e ka parasysh këtë se nëse ndokujt i paguan qera automatikisht i jep të drejtë të tjerëve të kërkojnë apo ta padisin KEDS-in për pagesë të qeras për shfrytëzim të pronave private duke qenë të vendosura shtyllat e rrjetit elektrik. Pa dashur të hyj në detaje rreth këtij propozimi, por duke u bazuar në atë që e tha drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë i cili ka edhe përgjegjësi morale dhe penale në lidhje me këtë propozim vendim në çoftë se bëhet fjalë për ndonjë shkelje apo lajthitje, sigurisht që KEDS nuk dëshiron të paguan qera për shfrytëzim të pronave përkatëse por dëshiron të vendos trafo të reja në ato dy fshatra me qëllim të përmirësimit të rrjetit të energjisë së atyre banorëve të cilët furnizohen me një energji elektrike të dobët, ne mund të themi këtu që KEDS është privatizuar dhe ka marrë disa obligime për investime e që mendoj se është ashtu me dokumente, mirëpo në realitet është diçka tjetër, andaj përderisa në Kosovë kemi vetëm një operatorë që bënë furnizimin me energji elektrike ne, jo me fajin tonë në një formë jemi bashkëfajtorë, kurse në anën tjetër ne nuk jemi ata që mund ta detyrojmë KEDS të veproi në bazë të marrëveshjes. Prandaj mendoj se ne sot ose duhet të bëhemi bashkëpjesëmarrës në mos furnizimin e fshatrave me energji elektrike më cilësore ose t'iu themi atyre banorëve se nuk jemi ne fajtor por është KEDS.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, diskutimi i parafolësit është shumë racional dhe qëllimshëm andaj kërkoj të kemi parasysh këtë.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, prapë po e përsërisë, ne nuk kemi nevojë të frikësohemi se mos po tërhiqet kompania KEDS, ngase KEK-u prodhon rreth 330 milion euro në vit kurse KEDS-it ia shet 150 milion euro në vit, sigurisht se shuma e mbetur destinohet për investime sepse po të ishte ndryshe me siguri se nuk do të privatizohej në këtë mënyrë, kështu që ne nuk duhet të kemi frikë se mos rastësisht KEDS po tërhiqet sepse fitimet e asaj kompanie janë të mëdha.

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, konsideroj se jemi duke u zhytur thellë në debat pa pasur nevojë fare, e them këtë ngase në bazë të marrëveshjes ekzistuese për bartjen e pronave nga KEK në KEDS, e vetmja pronë është zyra e cila gjendet në lagjen e Brecalive në Podujevë, kurse asnjë trafo çoftë në fshatra çoftë në qytet, në bazë të marrëveshjes të transferimit të pronave nga KEK në KEDS nuk janë përfshirë, e ceka këtë sepse kjo çështje duhet të merret parasysh. Vlen të ceket se katër prona private nga komunitetet e ndryshme u janë lëshuar kompanisë KEDS për të vendosur trafo vetëm e vetëm që ato lokalitete të kenë energji elektrike stabile.

Pas votimit u konstatua se me 28 vota për, 4 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS, sipas rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

-Pas kërkesave të shumicës së këshilltarëve të Kuvendit, kryesuesi propozoi të ketë pauzë deri në ora 13:00, propozim i cili u mbështetë.

-Pas pauzës prej një orë, mbledhja rifilloi në ora 13;10, fillimisht Kryesuesi i Kuvendit konstatoi kuorumin.

(Pastaj me kërkesë të këshilltarëve, znj. Mrikë Thaqi dhe z. Vehbi Rushiti bërë Kryesuesit të Kuvendit, u mbajt një minutë heshtje në nderim të të ndjerit Ismajl Abdullahu ish këshilltar i Kuvendit të Komunës në legjislaturën e IV.)

8. Komiteti për Komunitete

- **Raporti i punës për vitin 2014**
- **Plani i punës për vitin 2015**

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës sa jam i informuar zëvendës Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Shaban Osmani do ta paraqesë fjalën hyrëse.

z. Shaban Osmani, theksoi, në cilësinë e zëvendës Kryesuesit të Komitetit për Komunitete, para jush do të paraqesë një fjalë hyrëse për këto dy nënpika.

Raporti i Punës për vitin 2014 dhe Plani i Punës për vitin 2015 i Komitetit për Komunitete u është dërguar me kohë së bashku me thirrjen dhe Materialin e kësaj mbledhjeje. Jam i mendimit se këto dy materiale paraqesin punët dhe angazhimet më me rëndësi por edhe objektivat e parapara për vitin aktual. Konsideroj se materialet janë mjaftë të qarta dhe nuk është e nevojshme të paraqesë ndonjë informacion shtesë, përveç nëse ndonjë prej këshilltarëve kërkon të informohet për çështje të caktuara. Gjithashtu ju rikujtoj se për zbatimin e Planit të Punës, pas vlerësimeve të hollësishme, ky Komitet duke u bazuar në koston minimale për realizimin e planifikimeve më prioritare, Kuvendit të Komunës i ka rekomanduar që; të shqyrtoj mundësitë për sigurimin dhe destinimin e mjeteve buxhetore, si vijon: Për 3 vizita në fshatra 3 herë nga 150 €, për 4 vizita në Komunat tjera të Republikës së Kosovës 4 herë nga 200 €, për kremtimin e festës së flamurit të Komunitetit ashkali 600 €, për kremtimin e festës së flamurit të Komunitetit rom 300 €, dhe për organizimin e një vizite në Komunën e Podujevës të përfaqësuesve të Komiteteve për Komunitete të Komunave të regjionit të Prishtinës 300 €, ku gjithsejtë i bie 2,450.00 €, andaj besoj se për të mundësuar realizimin e këtyre aktiviteteve dhe për përmbushjen e këtyre objektivave nuk është ndonjë shumë e madhe për Komunën e Podujevës kur kemi parasysh se vullneti dhe angazhimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete nuk ka munguar deri më tash e as që do të mungoj në të ardhmen për përmbushjen e të gjitha përgjegjësive, mirëpo në të kaluarën kemi pas vështirësi në sigurimin e mjeteve financiare, por që një vendim të Kuvendit për sigurimin e mjeteve përkatëse është mëse i nevojshëm për t'i përmbushur detyrat e parapara të Komitetit.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, konsideroj se rekomandimi i paraqitur nga parafolësi, është bërë në pajtueshmëri dhe në koordinim me të gjithë përfaqësuesit e subjekteve të cilët marrin pjesë në atë Komitet, andaj duke u bazuar në këtë ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë rekomandim.

z. Naim Çunaku, theksoi, fillimisht e përshëndes paraqitjen për herë të parë të këtij raporti të punës së Komitetit për Komunitete gjë e cila është obligim ligjorë, mirëpo ne para vetës kemi edhe një Plan të punës për vitin 2015, në të cilin parashihet një kosto financiare, pa dashur që eventualisht të keqkuptohem nga ndokush se gjoja unë po e

kundërshtoj këtë kosto dua t'iu siguroj se nuk kam qëllim të tillë, mirëpo qëllimi im është që ta ngris një shqetësim i cili ka të bëjë me rëndimin e punës së Kuvendit të Komunës gjegjësisht që nuk jemi në hap me krijimin e kushteve për marrjen e autorizimeve të cilat i ka Kuvendi Komunal në bazë të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale sepse ne si Kuvend i Komunës me përjashtim të pagave dhe mëditjeve nuk kemi fond të ndarë për Kuvendin, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Komitetin për Komunitete, andaj për të qenë në hap me autorizimet përkatësisht me rolin që duhet ta marrim ne si organi më i lartë i Komunës e që sigurisht që shumica prej juve jeni në dijeni se Kuvendi i Komunës duhet ta ketë një linjë buxhetore për kategoritë mallra dhe shërbime, paga dhe mëditje, subvencione, linjë të cilën ne nuk e kemi, ndokush mund të pyes përse nuk e kemi këtë, mirëpo mund të shtrohet edhe pyetja, sa ne kemi qenë këmbëngulës dhe kush mund që neve si këshilltarë të Kuvendit të na e cungon një të drejtë ligjore.

Planin e Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2015 e përkrahi në tërësi, mirëpo pyes, çka me Komitetet dhe komisionet tjera të cilat i ka ngritur ky Kuvend, ku është puna e tyre dhe fondi për punën e tyre sepse kemi raste ku ne si Kuvend po marrim vendime për t'i kompensuar anëtarët e komisioneve të ndryshme për punën e tyre pa paur fond të ndarë, prandaj mendoj se në një formë jemi duke shkaktuar cungim të mundësisë së atyre që dëshirojnë të kryejnë punë sepse nuk kemi mundësi t'i shpërblejmë materialisht, prandaj rreth kësaj pike konsideroj se është dashur të jetë prezent në këtë mbledhje drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave për të dhënë shpjegime pse është duke ndodhur kjo që ne si Kuvend nuk kemi linjë buxhetore e që duhet ta kemi. Gjithashtu ne patëm një kërkesë për nënat lehona nga Grupi i LVV-së që në një formë edhe ajo është një ndërhyrje në buxhet dhe tani për tani nuk mund të realizohet por duhet të projektohet me rastin e miratimit të projektbuxhetit për vitin e ardhshëm. Pra unë nuk jam në dijeni se si mund të mbulohet kjo shumë e paraparë nga Komitetit për Komunitete, lidhur me këtë çështje bëjë thirrje që të kemi parasysh që nga muaji mars i këtij viti të fillohet me krijimin e linjës buxhetore në mënyrë që të miratohet ajo në projektbuxhetin e vitit 2016, sepse ne jemi këshilltarë të Kuvendit dhe nuk duhet të jemi të ndarë sa i përket grupimeve politike sepse Kuvendi duhet të funksionoj nga ne kuvendarët, pra kjo që e ceka kërkoj të jetë kërkesë. Gjithashtu jemi në dijeni se në Komunën e Podujevës janë funksionale edhe komitetet e fshatrave që absolut janë në kundërshtim me Udhëzimet Administrative të cilat e rregullojnë administrimin e nivelit nën komunal. Në këtë kontest ne si këshilltarë të Kuvendit nuk duhet të heshtim por të gjejmë mënyrë për t'i krijuar vetës funksionim më të mirë, pastaj të gjemë edhe mënyrë për t'i shpërblyer anëtarët e këshillave të fshatrave në bazë të Udhëzimeve Administrative.

Raportin e Punës dhe Planin e Punës së Komitetit për Komunitete ne e mbështesim mirëpo pyes, çka me koston financiare.

z. Haki Rudari, theksoi, ne Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje e kemi analizuar këtë Raport të Punës dhe këtë Planë të Punës së Komitetit për Komunitete, kemi vërejtur se është bërë një punë e mirë nga ana e Komitetit, mirëpo unë do të ndalem në çështjen që ka të bëjë me bashkëpunimin ku përveç bashkëpunimit me KFOR dhe Policinë e Kosovës kemi vërejtur bashkëpunim edhe me disa OJQ, për të cilat nuk jam në dijeni se a ekziston vërtetë ky bashkëpunim, pra është mirë të njoftohemi ne si Kuvend sa dhe si është bashkëpunimi me këto OJQ, apo vetëm është dhënë figurativisht në këtë dokument. Çështja tjetër që dua të cekë ka të bëjë me vështirësitë e Komitetit për Komunitete, vështirësi të cilat i paraqiten edhe Kuvendit të Komunës përkatësisht komisioneve të

ndryshme të cilat i ngritë ky Kuvend, andaj e përkrahi kërkesën e parafolësit që ky Kuvend të ketë një linjë buxhetore për raste të tilla në mënyrë që të mos mbetemi pengë e mungesës së mjeteve financiare për vizita dhe aktivitete të ndryshme. Gjithashtu çështja tjetër që ka të bëjë me vizitat e parapara nga Komitetit për Komunitete nëpër Komuna të ndryshme, mirëpo prapë në vitin 2015 paraqitet bashkëpunimi me të njëjtat OJQ, dhe këtu nëse mundemi të njoftohemi se ku dhe si veprojnë këto OJQ dhe si është bashkëpunimi i Komitetit për Komunitete me ato OJQ apo vetëm figurojnë në këto dokumente. Sa i përket rekomandimit përkatësisht shumave të mjeteve financiare të parapara nga Komitetit për Komunitete për realizimin e aktiviteteve të tyre, ne si Grup edhe më parë kemi dhënë vërejtje dhe për mos mbështetje të organizatave dhe shoqatave të ndryshme për realizimin e aktiviteteve të tyre të ndryshme, siç ishte rasti i shënimit të Ditës së Flamurit ose Dita e Çlirimit të qytetit të Podujevës ku kemi pasur mungesë të flamujve me arsytim se nuk ka mjete financiare, dhe shumë raste tjera ku OJQ dhe shoqata të ndryshme kanë vështirësi financiare për organizimin e aktiviteteve të tyre. Prandaj ne si Grup e përkrahim raportin e Punës dhe Planin e Punës së Komitetit për Komunitete, mirëpo i kemi edhe vërejtjet tona të cilat kërkojmë të merren parasysh.

z. Shaban Osmani, theksoi, lidhur me çështjen që e ngriti parafolësi rreth bashkëpunimit, unë ju njoftoj se Komiteti për Komunitete ka kontakte dhe bashkëpunim me z. Liman Zeqirin shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Stacionin e Policisë në Podujevë, me Policinë Rajonale Kufitare Veriu, OSBE-në, KFOR-in, kurse Voice Of Roma është një organizatë e cila ndër të tjera shpërndan bursa për nxënësit dhe studentët e komuniteteve ashkalinj dhe rom.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, më vie mirë që Komiteti për Komunitete ka prezantuar dy dokumente të tilla para Kuvendit të Komunës dhe unë i mbështes ato, mirëpo e keqja e kësaj është se në Planin e Punës së këtij Komiteti parashihet një shumë e mjeteve buxhetore. Neve si Kuvend i Komunës dhe trupave të Kuvendit kemi probleme të shpeshta sa i përket krijimit të kushteve për punë përkatësisht nuk kemi ndarje të mjeteve sepse çdo komision apo aktivitet i Kuvendit dhe trupave të tij ka edhe koston financiare e që ndoshta jemi një ndër Komunitat e vetme në Kosovë që nuk kemi të ndarë buxhet për Kuvendin e Komunës, sepse në bazë të kontakteve që kamë me këshilltarë të Kuvendeve të ndryshme shumica e tyre kanë buxhet të tyre po ashtu posedojnë edhe automjet për nevojat e tyre e të tjera, dhe në këtë aspekt konsideroj se është mirë që me rastin e përgatitjes së projektbuxhetit të Komunës të krijohet një linjë dhe të ndahet buxhet për Kuvendin e Komunës dhe për trupat funksionale të tij.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, buxheti i Komunës së Podujevës është i miratuar dhe së bashku me atë është miratuar edhe buxheti për Kuvendin e Komunës ku 118,000.00 € janë për pagat e këshilltarëve dhe të anëtarëve të Komiteteve të përhershme, por nëse kemi nevojë për intervenim ne mund ta bëjmë atë me rishikim të buxhetit. Sa i përket pagesave ose kompensimeve të anëtarëve të komisioneve të Kuvendit pritet që së shpejti të nxirret nga niveli qendrorë një Udhëzim Administrativ i cili do ta rregulli këtë çështje sepse ky është problem për të gjitha Komunitat, kurse për mallra dhe shërbime për Kuvendin e Komunës ne i kemi të miratuara 8,000.00 €, shumë kjo e cila mendoj se është e vogël dhe po t'i marrim 2,450.00 €, të cilat i ka kërkuar Komiteti për Komunitete atëherë për Kuvendin e Komunës do të mbetet shumë e vogël. E kamë thënë dhe po e përsërisë se është mirë që vendimet tona si Kuvend të jenë të zbatueshme dhe mos të ndodhë që të marrim vendim i cili mund të ketë një kosto

financiare të papërballueshme dhe të mos mund të zbatohet. Lidhur me këtë shumë të paraparë nga Komiteti për Komunitete mendoj se duhet të zvogëlohet për 1,000.00 €, pastaj me rishikim të buxhetit nëse mundemi e rrisim prapë atë shumë të mjeteve.

z. Shaban Osmani, theksoi, anëtarët e Komuniteteve kanë kërkuar shumë më të madhe mirëpo ne e kemi zvogëluar atë në 2,450.00 €, andaj unë nuk jam për mos zvogëlim të asaj shume, unë nuk kërkoja por vetëm e lexova rekomandimin Komitetit.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, lidhur me aktivitetet e Komitetit për Komunitete unë mund të bëjë një krahasim me festat tona si, 28 nëntorin, 19 qershorin e të tjera, të cilat ne për shkak të mjeteve buxhetore nuk i festojmë ashtu si duhet, mirëpo jemi në dijeni se si Kuvend i Komunës nuk kemi linjë dhe buxhet të ndarë, andaj nuk mund të marrim vendim dhe të ndajmë shuma të tilla ngase pastaj do të jetë e vështirë realizimi i tij. Sa i përket Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2015 përkatësisht shumës së mjeteve buxhetore të paraparë, mendoj se këtij Komiteti nuk i bëhet vonë që deri në mbledhjen e radhës të shikohen linjat buxhetore nga ana e drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave se mund apo jo të mbulohet ajo shumë, sepse linjë buxhetore për punë shtesë dhe aktivitete të tilla nuk ka të miratuar dhe ne nuk mund të obligojmë drejtorin e DBF t'i gjen mjetet e parapara do si do, por të miratojmë këto dy dokumente sot me rekomandim që në mbledhjen e radhës të vendosim për shumën.

z. Naim Çunaku, theksoi, lidhur me këtë pikë propozoj që Raporti i Punës të ndahet nga Plani i Punës, me qëllim që mos të thuhet pastaj se ne si Kuvend kemi imponuar diçka të tillë, Raporti i Punës është gjithçka në rregull, kurse sa i përket Planit të Punës gjegjësisht shumës së mjeteve financiare të kërkuara nuk mendoj se ka vend të zvogëlohet ajo shumë e paraparë për aktivitete të ndryshme njëvjeçare të Komitetit për Komunitete, mirëpo mendoj se është mirë që shuma përkatëse e mjeteve buxhetore të shtyhet për mbledhjen e radhës me qëllim që të konsultohet edhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave për mundësinë e gjetjes apo jo të mjeteve financiare përkatëse, pastaj të sqarohemi ne si Kuvend a dëshirojmë të miratojmë apo jo.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hedh në votim propozimin e parafolësit z. Naim Çunaku.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u përkrahë Raporti i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2014, dhe njëkohësisht u miratua edhe propozimi i z. Naim Çunakut sipas së cilit Plani i Punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2015 miratohet me rekomandim që për ndarjen e mjeteve të parapara në këtë plan drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në mbledhjen e radhës të na sqaroi se a mund apo jo ta miratohet ajo shumë.

9. Propozimi i vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Sipas kërkesave të Sabit Halitit nga Podujeva dhe Muharrem Isufit nga fshati Majac)

znj. Adelinë Stublla, theksoi, vetë fakti që këto pika të rendit të ditës respektivisht për destinim të përhershëm të tokave bujqësore në tokë ndërtimore, është bërë rutinë që në çdo seancë kemi pika të tilla me material prej dy fletëve e jo më shumë, material për ndërrime të përhershme respektivisht për rritje të vlerave të pronës, pika me nga dy fletë aludon në qarrosje të Ekzekutivit të Komunës për të mos thënë korrupsion sepse të gjithë jemi në dijeni se sistemi i drejtësisë në Kosovë funksionon si më dobëti ndër sistemet

tjera. Pra plani zhvillimorë urbanistik do të duhej të merrej parasysh në raste të destinimit të parcelave në fjalë ku të gjithë jemi në dijeni se në fshatin Majac ajo rrjedh e ujit mund të bëhet hidrocentral, andaj ne Lëvizja Vetëvendosje mendojmë më larg dhe me këtë rast kërkojmë dokumente shtesë në strategji zhvillimore respektivisht në planin zhvillimorë urbanistik, e pastaj të hedhën këto propozime në votim.

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, e shohë si nevojë që në emër të kolegut tim drejtorit të Drejtorisë përkatëse, parafolëses t'i jap një sqarim, lidhur me kërkesën për fshatin Majac mund të them se është kërkesë për pronë private, dhe nuk jam në dijeni se me planin zhvillimorë urban parashihet ndokund ndonjë hidrocentral e veçmas në atë fshat, andaj në rastin konkret kemi të bëjmë me pronë private të destinuar si tokë ndërtimore për bujqësi përkatësisht ai person ka ndërtuar stallë në 10 ari në atë pronë mirëpo pas inspektimit në terren është konstatuar se objekti është më i madh dhe se duhet të shndërrohet edhe një pjesë e asaj prone për t'i plotësuar kushtet për leje ndërtimore. Pra nuk mendoj se duhet t'iu nxjerrim probleme atyre që kanë ide dhe punojnë në zhvillim të bujqësisë.

z. Naim Çunaku, theksoi, mendoj se ky propozim vendim duhet të përkrahet, gjithashtu mendoj se nëse Kosova ndonjë ditë harton plane gjenerale për zhvillim çoftë për ndërtimin e hidrocentraleve çoftë për projekte tjera kapitale ka mundësi që me një shpallje në interes të përgjithshëm mund ta realizoi atë projekt. Prej që kur jam pjesë e këtij Kuvendi e kam mbrojtur parimin, që çdo njëri e ka të drejtën e vet ta menaxhoi si të dëshiron vetë pronën e vetë private, andaj për mendimin tim nuk është e arsyeshme të mos i mundësojmë ndokujt që në pronën e tij të mos ndërtoj diçka që ai ka interes për zhvillimin e vetë dhe familjes së tij, dhe duke u nisur nga kjo nuk kam si mos ta përkrahi.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kërkesat e tilla janë me shkrim dhe i drejtohen organit kompetent të Komunës, ku organ i tillë është Kuvendi i Komunës, nëse prona është e klasës 1-4, vendimi dërgohet në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ku me shqyrtimin e tij merret një komision ndërministrorë, andaj këto prona nuk shndërrohen me dokumente pa u konfirmuar nga ana e Ministrisë. Lidhur me atë që parafolësja e tha se aludohet në qarrosje, unë nuk e besoj një gjë të tillë, por nëse ndokush ka informata sa i përket asaj çështjeje lirshëm mund të thoni dhe me siguri se do të merren organet tjera me ato raste.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, deri sa rreth një orë më parë ky Kuvend në një formë ia fali pronën publike kompanisë private KEDS, nuk e shohë të arsyeshme që tani për pronë private të mos ia mundësojmë atij personi ta shfrytëzon pronën e vetë si dëshiron ai vet.

z. Haki Rudari, theksoi, ne në këtë mbledhje diskutuam për programin trevjeçarë të banimit, në të cilin thuhej se kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet ruajtjes së tokës bujqësore, mendoj se tani ne po biem në kontrast me fjalë tona, ne si Grup edhe si individ në parim asnjëherë nuk kemi qenë kundër zhvillimit të bujqësisë ose kundër zhvillimit të ndonjë biznesi, që do të thotë se në parim jemi për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillim të bizneseve mirëpo mendojmë se duhet ta ruajmë tokën bujqësore, dhe këtë e tha edhe znj. Adelinë Stublla se duhet të kemi kujdes se mos po miratojmë diçka që eventualisht mund të parashihet me plan zhvillimorë të Komunës në atë pjesë. Vlen të ceket se ka raste të tilla për të cilat jam në dijeni që nuk janë proceduar në Kuvend por janë lënë në sirtarë të Komunës me kohë të tëra.

Pas votimit u konstatua se me 27 vota për 2 vota të përmbajtura dhe asnjë votë kundër u miratuan;

-propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Sabit Halitit nga Podujeva, dhe

-propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Muharrem Isufit nga fshati Majac.

10. Informatë e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës, lidhur me zhvillimet e proceseve të gjertanishme për ndërtimin e shtëpive në lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc dhe përzgjedhja e familjeve për vendosje në ato shtëpi.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj informata është shumë e qartë dhe e kompletuar mirë rreth punës së komisionit përkatës, informatë e cila është përgatitur në bashkëpunim me anëtarët e këtij komisioni të cilët i falënderojmë dhe i përgëzojmë për punën e bërë deri më tani.

z. Bahri Selimi, theksoi, është për tu lavdëruar puna e komisionit për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në Balloc, sepse është dashur të merret me strehimin e 50 familjeve gjë e cila ka qenë një çështje e ndjeshme dhe aspak e lehtë kur kemi parasysh se në çfarë gjendje kanë jetuar ato familje deri tani, mirëpo unë si iniciues i kësaj informate fillimisht dua të them se kjo informatë nuk ka të bëjë me atë se çfarë unë kam kërkuar, e them këtë ngase unë kam kërkuar një informatë të punës së komisionit dhe nuk kam kërkuar historik të rrjedhave të punës së komisionit, shembull, që në fillim ceket memorandum i lidhur në vitin 2013 mes Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu dhe zëvendës ministrit të Ministrisë përkatëse z. Fatmir Shurdhaj, kurse sipas programit trevjeçar të banimit ai memorandum figuron në vitin 2014, pra kemi kundërthënie mes datave të memorandumit sikurse që kemi kundërthënie mes shumës së ndarë për ndërtimin e atyre shtëpive ku në njërin dokument figuron 430,000.00 € kurse në tjetrin 425,000.00 €, e që mendoj se nëse këto informata janë nga e njëjta Komunë dhe nga i njëjti Ekzekutiv duhet të jenë në përputhje të plotë. Sa i përket çështjes së ndarjes së shtëpive unë kam para vetës një tabelë ku janë të evidentuara vetëm familjet përfituese 17 familje të Dëshmorëve, 10 veteran të luftës, 7 invalidë të luftës, 14 viktima civile dhe 2 me asistencë sociale, gjë të cilën më së paku e kam kërkuar këtë, por unë kam kërkuar që të sjellën emrat e përfituesve me numrin e poenëve të fituar konform Rregullores që ne e kemi miratuar në këtë Kuvend sipas së cilës familjet e Dëshmorëve përjashtohen nga të gjitha kriteret, dhe pyes komisionin se a kanë qenë 17 familjet e Dëshmorëve përfitues të beneficioneve të familjeve të Dëshmorëve, pyes sepse kam informata se nuk janë të gjitha, e që mendoj se ka qenë shumë e lehtë të bazohej në Ligjin për kategoritë e dala nga lufta i cili thotë, përfitues të benefiteve të familjeve të Dëshmorëve janë familja e ngushtë me të cilën nënkuptojmë dy prindërit, gruan dhe fëmijët, ndërsa unë në këtë listë kam vërejtur se ka përfitues në emër të familjes së Dëshmorëve të cilët nuk janë trashëgimtarë të familjeve të Dëshmorëve. E ngrita këtë çështje jo për arsye pse këta njerëz kanë përfituar por për keqpërdorimet që janë bërë në emër të familjeve të Dëshmorëve sepse konsideroj se nuk mund të përfitoj ndokush në emër të familjes së Dëshmorit në çoftë se nuk është trashëgimtar i familjes së Dëshmorit, prandaj duke qenë iniciues i kësaj pike i bëra publike këto gjëra ngase tani ndihem shumë keq kur jam në

dijeni se ka keqpërdorime të emrit të Dëshmorëve sepse mendoj se ato familje kanë mundur të përfitojnë edhe duke u thirrur në kategori tjera si, veteran të luftës, viktimë civile e të tjera, por në as një rast nuk është dashur të thirren si familjarë të Dëshmorëve. Lidhur me invalidët e luftës e kam një paqartësi, në këtë informatë thuhet se kanë përfituar 7 familje, kurse unë jam plotësisht i bindur dhe shumë i saktë se në bazë të dokumentacionit që unë e posedoj, në Lagjen e Dëshmorëve jetojnë 4 invalidë të luftës, andaj si ka mundësi që të përfitojnë 7 familje dhe të mbesin edhe 5 familje të tjera në procedurë të përfitimit të shtëpive, dua të them se neve na dalin 12 familje të invalidëve të luftës kurse në bazë të dokumentacionit janë vetëm 4 familje, besoj se ka pas mundësi dhe është dashur të ndahen ata të cilët janë invalid të luftës nga ata të cilët kanë qenë të lënduar gjatë luftës. Sa i përket viktimave civile dhe personave me asistencë sociale nuk kamë asgjë kundër, mirëpo qëllimi im ka qenë që ky Kuvend të njoftohet në detaje për punën e Komisionit përkatës, mirëpo do të ishte mirë të publikohej numri i poenëve të fituara të të gjitha familjeve në mënyrë që ne të sigurohemi se a ka apo nuk ka në listën e përfituesve familje me më pak poena se sa ndonjë familje jo përfituese. Ndihej shumë mirë që të gjitha familjet e Dëshmorëve kanë qenë përfituese të atyre shtëpive, mirëpo nuk ndihem mirë sa i përket keqpërdorimit të emrit të tyre nga disa familje.

z. Avni Ajeti, theksoi, e përmendi edhe parafolësi se në këtë Kuvend kemi miratuar një Rregullore për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshati Balloc, dhe ne si komision kemi punuar në bazë të kësaj Rregulloreje.

Sa i përket akuzave të parafolësit se gjoja ka pas keqpërdorime nga disa familje duke u thirrur në emër të Dëshmorëve, konsideroj se nuk jemi kompetent për këtë çështje sepse ne kemi qenë komision i përbërë nga anëtarë të të gjitha subjekteve politike dhe nga shoqata e dala nga lufta, dhe kemi punuar-vepruar në bazë të dokumentacionit që na është prezantuar nga familjet që jetojnë në atë lagje, andaj nuk kemi qenë kompetent të bëjmë hulumtime për prejardhjen e atyre dokumentacioneve ose me çfarë baze kanë marrë dokumente të tilla, faktikisht i kemi respektuar ato dokumentet të cilat kanë qenë zyrtare të nënshkruara dhe të vulosura, e që ne si komision nuk jemi kompetent t'i refuzojmë. Lidhur me disa krahasime me numra që i bëri parafolësi të disa kategorive përfituese, unë kamë qenë shumë i interesuar dhe në komision kamë propozuar që të vendosim një rregull në bazë të cilës t'i shqyrtojmë vetëm librezat e aplikantëve të cilët janë nga Komuna e Podujevës. Gjithashtu ne kemi kërkuar nga disa invalid të caktuar të cilët i kanë pasur librezat e invalidit të luftës të lëshuara në Prishtinë që edhe një herë të na prezantojnë librezat e lëshuara në Podujevë. Pra ne si komision nuk kemi mundur t'i ndalim apo t'i përjashtojmë ata individ sepse dokumentacioni ka qenë në rregull dhe i lëshuar nga shteti i Kosovës, ndërsa sa i përket prejardhjes së atyre dokumenteve në të ardhmen do të verifikohen nga organe tjera përkatëse. Lidhur me publikimin e numrit të poenëve të fituar nga familjet përfituese dhe ato jo përfituese, pajtohem me parafolësin i cili e tha se është dashur të publikohen, dhe ju njoftoj se numri i poenëve është transparent dhe mund të publikohet kur të dëshironi.

z. Kadri Avdiu, theksoi, ne si komision i ngritur nga ky Kuvend kemi menduar të sjellim në Kuvend një informatë rreth ndarjes së shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, ndërsa sa i përket asaj që u kërkuar që të jetë publike lista e përfituesve dhe atyre që janë në pritje të përfitimit, me emra dhe mbiemra dhe me numër të poenëve të fituar, nuk është diçka që nuk mund të bëhet ose që nuk duhet ta keni, por atë mund ta merrni kur të dëshironi sepse nuk asgjë që duhet të mos bëhet publike.

Në vizitën e parë që kemi bërë ne si komision kemi evidentuar 17 familje të dëshmorëve në atë Lagje, në Rregulloren e miratuar në këtë Kuvend thuhet se familjet e Dëshmorëve janë përfituese të shtëpive pa kurrfarë kriteri, ta marrim shembull të ardhurat personale ose benefitet ju takojnë dy prindërve, gruas dhe fëmijëve të Dëshmorit, ndërsa në rastin e përfitimit të shtëpisë në shfrytëzim përfshihen edhe vëllezërit e Dëshmorëve, gjë për të cilën ne nuk mund të themi se nuk është familje e Dëshmorit, vlen të ceket se ne kemi pas rast që e ka pasur të zgjidhur problemin e banimit mirëpo nuk kemi bërë ndarje sepse ka qenë familje e Dëshmorit. Sa i përket dokumentacionit të prezantuar se a janë apo nuk janë invalidë të luftës ne kemi pranuar dokumente valide të vulosura nga Ministria përkatëse, e që ne nuk jemi organ hetues që ta ndjekim atë çështje, por na është dashur të veprojmë në bazë të dokumentacioneve. Sa i përket kategorisë së tretë që ka qenë për veteranë të luftës gjithashtu jemi bazuar në librezat aktuale të cilat i posedon kjo kategori, vlen të përmendet se anëtarë në komisionin përkatës është edhe përfaqësuesi i tri organizatave të dala nga lufta i cili i ka vërtetuar dokumentacionet përkatëse për kategori përkatëse. Pra neve si komision sigurisht se na vie keq që janë ndërtuar vetëm 50 shtëpi dhe kanë mbetur pa përfituar edhe 84 familje.

Puna e komisionit ka qenë me të vërtetë e rëndë, e ndjeshme dhe me presione të mëdha sepse secila nga ato familje kanë nevojë për shtëpi të reja por ne kemi vepruar në bazë të Rregullores përkatëse dhe në bazë të dokumentacioneve të ofruara nga familjet, andaj lirshëm mund të them se puna është kryer me nderë nga ana e komisionit ku pothuajse të gjitha vendimet janë marrë në mënyrë unanime, ndërsa kemi pasur vetëm një ankesë me shkrim e cila është vërtetuar se nuk ka pasur të drejtë sa i përket poenëve të fituar.

z. Bahri Selimi, theksoi, nuk dua që ajo që e potencova më parë të keqkuptohet dhe të keqinterpretohet nga ndokush, sepse unë nuk jam kundër asnjë familjeje përfituese, mirëpo Rregullorja e miratuar në këtë Kuvend i ka përcaktuar shumë qartë se kush është përfitues i shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, janë familjet e Dëshmorëve, që bëjnë pjesë trashëgimtarët e asaj familjeje, kurse sa i përket asaj se kush janë trashëgimtarët e familjes së Dëshmorëve mendoj se ligji përkatës shumë qartë e rregullon çështjen e përfitimit të benefiteve të familjeve të Dëshmorëve ku përfshihen prindërit, bashkëshortja ose bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, dhe nëse është në vijim të shkollimit deri në moshën 26 vjeçare. Prandaj në këtë rast konsideroj se komisioni e ka shkelur Rregulloren, dhe ka fakte për këtë.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, sa i përket anëtarëve të komisionit përkatës mendoj se janë persona të cilët i njohin shumë mirë familjet e Dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e luftës dhe kategoritë tjera të dala nga lufta, madje edhe pa poseduar dokumente fare, dhe nuk kam fare dyshim në përbërjen e komisionit. Mendoj se puna e komisionit ka qenë e vështirë, konsideroj se vërtetë është vështirë të vendosen ose të shpallen përfituese 50 familje kurse në anën tjetër të lihen rreth 85 familje tjera. Pra nuk është mirë të bëhen polemika të panevojshme rreth kësaj çështjeje ngase anëtarët e komisionit përkatës të gjithë kanë qenë pjesë e luftës së UÇK-së dhe pjesën dërrmuese të atyre familjeve i njohin dhe nuk besoj se mund të ndodh të kenë bërë ndonjë keqpërdorim.

z. Haki Rudari, theksoi, konsideroj se ajo që z. Bahri Selimi e tha u keqkuptua këtu me apo pa qëllim, shumica e këtyre çështjeve që u përmenden këtu ne në komision i kemi debatuar bukur gjatë. Se kush është trashëgimtarë i familjes së Dëshmorëve, është e vërtetë ajo që u cek se ligji përkatës si trashëgimtarë të Dëshmorëve i nje prindërit, bashkëshortin dhe fëmijët, gjë e cila është diskutuar edhe në takimet e komisionit. Unë si

anëtarë i komisionit kam marrë pjesë në të gjitha takimet dhe për të gjitha i marrë përgjegjësitë, përveç në një rast nuk e marr përgjegjësin sepse kam shprehë mospajtime dhe e kam lëshuar takimin, rast për të cilin përgjegjësinë e mbanë shoqata e familjeve të Dëshmorëve, gjë të cilën e kam thënë në përfundim të ndërtimit të 30 shtëpive të para përkatësisht në takim kam thënë se përgjegjësinë e mbajnë shoqatat e dala nga lufta, ngase ne jemi munduar të jemi sa më transparent dhe kemi kërkuar vërtetime dhe dokumente shtesë të cilat edhe na janë ofruar dhe ne tash nuk mund të jemi përgjegjës për dokumente të lëshuara nga Ministria përkatëse. E përsërisë se z. Bahri Selimi u keqkuptua nga disa këshilltarë, mirëpo ai u thirr në çështje ligjore që për mendimin tim është shumë e drejtë dhe e qartë se kush është trashëgimtarë i familjes së Dëshmorëve. Komuna e Podujevës ka pas për obligim sigurimin e lokacionit gjë të cilën edhe e ka bërë, mirëpo në fillim të këtij procesi është dashur që Komuna bashkërisht me Ministrinë përkatëse të gjejnë gjuhë të përbashkët që mos ndërtohen shtëpi individuale por të ndërtohet objekt kolektiv sepse do të ishte më lehtë të menaxhohet me situata të ndryshme dhe do të mundësonte të kenë një hapësirë më të madhe, gjithashtu është dashur të merrej parasysh edhe hapësira e atyre shtëpive dhe numri i anëtarëve të familjeve sepse ashtu si janë konsideroj se janë shumë të vogla.

z. Kadri Avdiu, theksoi, më duket shumë e pakuptimtë të debatohet kaq gjatë dhe të bëhet gjithë kjo zhurmë për tri kategori të cilat për mendimin tim janë më të ndjeshmet në Kosovë, madje për çka bëhet kjo, për ndërtimin e 50 shtëpive me nga 54m², ndarjen dhe dhënien në shfrytëzim 50 familjeve të veteranëve të luftës, familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe rasteve më të rënda sociale. Andaj konsideroj se është për keqardhje që sot në këtë Kuvend bëhet gjithë kjo zhurmë për ato kategori ngase me ndarjen e atyre shtëpive nuk mund të thuhet se është bërë diçka e madhe për ato kategori, për të mos thënë nuk kemi bërë asgjë për ato familje sepse qe 15 vite ato familje kanë jetuar në kontejnerë. Nuk e kam pritur një debat të tillë sepse kam menduar që kjo informatë të jetë vetëm informuese për Kuvendin për ndarjen e atyre 50 shtëpive. Pra unë i uroj familjet përfituese që t'i gëzojnë ato shtëpi me shpresën se do të vazhdoj projekti për ndërtimin edhe të shtëpive tjera në mënyrë që të jenë përfituese të gjitha ato familje të cilat ende jetojnë në ata kontejnerë dhe të zgjidhet kjo çështje njëherë e përgjithmonë.

z. Avni Ajeti, theksoi, edhe përkundër disa çështjeve të cilat u than deri tani, unë i falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit duke përfshirë edhe përfaqësuesin e shoqatave të dala nga lufta z. Fadil Mulliqin, dhe e them me përgjegjësi të plotë se kemi qenë shumë konstruktiv dhe jemi munduar të kryejmë punën sa më mirë. Lidhur me këtë ju njoftoj se unë personalisht kam qenë edhe i kërcënuar dhe kam dhënë edhe deklarata në Polici, ndërsa tani nga një këshilltarë këtu thuhet çështje të cilat as unë e as anëtarët e komisionit nuk e meritojmë.

z. Flakron Gashi, theksoi, nuk dëshiroj të bëjë krahasime se kujt i ka takuar dhe kujt jo ndarja e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, mirëpo si magjistër i shkencave juridike mora fjalën me qëllim t'i bëjë disa sqarime. Çdo përfitim i çdo qytetari të këtij vendi kur bazohet në kriteret e parapara me ligj, mund të tërhiqet ai përfitim në rast të vërtetimit se i njëjti ka përfituar me falsifikim të dokumenteve me qëllim të përfitimit të një të drejte, kështu që verifikimet për të gjitha kategoritë e dala nga lufta janë duke u bërë në nivel shtetërorë dhe në momentin që mund të vërtetohet se ndokush prej atyre personave nuk e gëzon atë të drejtë mund të iniciohen procedura dhe t'i tërhiqet e drejta

për ta shfrytëzuar shtëpinë në atë lagje. Prandaj mendoj se është mirë të kemi më shumë ankesa ne si këshilltarë të Kuvendit se sa që ka ankesa nga vetë palët.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit i falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, për punën e tyre, mendoj se është bërë një punë e mirë dhe transparente nga ana e komisionit gjë të cilën e tregon fakti që në gjithë këtë proces ka pasur vetëm një ankesë me shkrim e cila është shqyrtuar dhe është konstatuar se komisioni ka pasur të drejtë. Andaj meqë për këtë informatë nuk parashihet t'iu nënshtrohet procedurave të votimit, e konsideroj të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës.

11. Të ndryshme

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë kemi miratuar planin e punës së Kuvendit të Komunës dhe në atë parashihet të mbahet edhe një mbledhje në fund të këtij muaji, pas konsultimit që pata me Zyrën ligjore, kërkoj mirëkuptim nga ana juaj se në mbledhjen e radhës që me siguri se do të mbahet në fund të këtij muaji, nuk do të mund të përgatitet Ekstrakti i Procesverbalit të kësaj mbledhjeje.

z. Naim Çunaku, theksoi, jemi në dijeni se në gjithë Kosovën është duke u zhvilluar një kampanjë e organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, për legalizimin e ndërtimeve pa leje, kampanjë të cilës i është bashkëngjitur edhe Komuna jonë ku dhe shihet një interesim i madh i qytetarëve për t'iu nënshtruar procedurave përkatëse të legalizimit. Kam vërejtur një fakt të cilin dua ta ngris si pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Administratës, pse qytetarët e Komunës së Podujevës duhet të paguaj tre euro për të bërë kërkesë për legalizimin e ndërtime pa leje, e ngrita këtë pyetje sepse sa kam informacione Komuna e Podujevës është e vetmja në Kosovë e cila e aplikon këtë pagesë, pra mendoj se është dukuri vetme kjo në Kosovë që Komuna jonë e aplikon ndërsa në asnjë Komunë tjetër në Kosovë nuk është e shfaqur kjo dukuri.

z. Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje kërkoj që në seancën e radhës ta kemi pikë të rendit të ditës:

Raport nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.

Pasi më nuk pati të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 14;30

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-101838
Podujevë,
04 shkurt 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**